



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 186 Akti

Nr. 293 Vendimi  
Tiranë, më 10.9.2020

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësor, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datën 4 shtator 2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artur Gaxha**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Firdes Shuli dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri, znj. Pamela Qirko.
- 4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 3.10.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi, znj. Firdes Shuli; u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Gaxha.
- 5.** Me vendimin nr. 17, datë 9.3.2020, Komisioni vendosi rishpërndarjen me short të çështjeve të vitit 2018 dhe 2019 të komisionerit, znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës të saj në punë për shkaqe objektive.
- 6.** Në vijim, me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit, pas procedurës së rishpërndarjes me short, në çështjen e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, rezultoi anëtar zëvendësues komisioneri Roland Ilia, i cili deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.
- 7.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Gaxha, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 8.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

**9.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**10.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**11.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**12.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka dërguar një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (d) nuk ka kryer deklarim të rremë dhe; (e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**13.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Gaxha<sup>3</sup>.

**14.** Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport<sup>4</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot, datë 31.10.2017.

<sup>3</sup> Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e me nr. \*\*\*, datë 28.5.2020, të KDZH-së.

<sup>4</sup> Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale me nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2019.

**15.** Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**16.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 17.6.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Gaxha; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës së subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**17.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në datën 17.6.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 22.6.2020, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 1.9.2020.

**18.** Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCAT DËGJIMORE**

**19.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 21.7.2020.

**20.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Artur Gaxha u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 4.9.2020, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

**21.** Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**22.** Z. Artur Gaxha ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**22.1** Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka bërë disa kërkesa për shtyrjen e afateve të vendosura nga Komisioni për dorëzimin e prapësimeve dhe zhvillimin e seancës dëgjimore. Komisioni, pasi vlerësoi rast pas rasti se kërkesat ishin objektive, në garantim të të drejtave të subjektit për një proces të rregullt ligjor, i dha gjithë kohën e mjaftueshme për t'u mbrojtur dhe paraqitur prapësimet dhe provat e tij.

**22.2** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur; ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**23.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**23.1** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**23.2** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**23.3** Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**24.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**25.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**25.1** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha.

**25.2** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**Në deklaratën** “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

**26. Pasuria e llojit apartament banimi<sup>6</sup>, me sipërfaqe 124.8 m<sup>2</sup>**, i ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në shumën prej 1,000,000 lekësh, në bashkëpronësi me bashkëshorten, i përbërë prej: (i) apartament banimi me sip. 64 m<sup>2</sup> blerë me kontratën e shitblerjes<sup>7</sup> së datës 1.10.2004; dhe (ii) shtesë anësore për banim me sipërfaqe 60.6 m<sup>2</sup> legalizuar<sup>8</sup> në datën 14.11.2011– pasuri për të cilën janë kryer shpenzime legalizimi në shumën 35,000 lekë dhe shpenzime rivlerësimi në shumën 206,605 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar kursimet nga pagat për vitet 1990 – 2004.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtesa anësore është ndërtuar para blerjes së apartamentit prej tij dhe se çmimi prej 1,000,000 lekësh është çmimi total për të gjithë apartamentin, pasi shtesa anësore është shtesë e apartamentit ekzistues.

Referuar deklaratës fillestare të pasurisë (dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 19.3.2004) konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me vlerë 2.000.000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga pagat; dhe (ii) të ardhurat e përfituara nga pjesa takuese e shtëpisë së prindërve në Tepelenë, pas pjesëtimit vullnetar.

<sup>6</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/1 në dosjen e ILDKPKI): (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 17.2.2016; (2) kartelën e pasurisë, hartën treguese dhe planimetrinë e apartamentit; (3) dokumentin, aplikim për rivlerësim pasurie, datë 27.3.2013, dhe urdhërshirimi në “Credins Bank”, datë 25.7.2013, për rivlerësimin e pasurisë; (4) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 1.10.2004; (5) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.10.2004, për pasurinë nr. \*\*\*, e llojit apartament me sipërfaqe 64.2 m<sup>2</sup>; (6) dokumentin - pasqyra e rivlerësimit të pasurisë së llojit apartament me sipërfaqe 64.2 m<sup>2</sup>; (7) leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 14.1.2011; (8) formular i pagesës së parcelës ndërtimore dhe faturë arkëtimi datë 14.6.2014; (9) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 9.10.2012, për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit apartament, me sipërfaqe 60.6 m<sup>2</sup> + kartela e kësaj pasurie; (10) dokumentin - pasqyra e rivlerësimit të pasurisë së llojit apartament, me sipërfaqe 60.6 m<sup>2</sup>.

<sup>7</sup> Kontratë noteriale shitblerjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

<sup>8</sup> Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2011.

## Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

ZVRPP-ja Tiranë<sup>9</sup>, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament banimi me sipërfaqe 124.8 m<sup>2</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 1.10.2004 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë<sup>10</sup> nga shtetasi H. Y. (babai bashkëshortes së subjektit), pasurinë me nr. \*\*\*, të llojit apartament banimi me sipërfaqe 64.2 m<sup>2</sup>, për vlerën 1,000,000 lekë – shumë e cila sipas deklarimit të palëve është likuiduar plotësisht në muajin tetor 2003. Gjithashtu, referuar kësaj kontrate – palët kanë deklaruar se dorëzimi i apartamentit është bërë në tetor të vitit 2003. Kjo pasuri, është rivlerësuar në datën 25.7.2013 në vlerën prej 12,262,200 lekësh – dhe është paguar tatimi në vlerën prej 112,622 lekësh.

Në vlerësim të faktit se në deklarimin fillestar (i cili përfshinte pasuritë deri në datën 31.12.2003) subjekti e ka deklaruar këtë pasuri objekt hetimi, të blerë sipas kontratës së shitjes në datën 1.10.2004, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë nëse për zotërimin e këtij apartamenti përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes ka pasur ndonjë kontratë porosie apo dokument shkresor dhe nëse jo, të shpjegojë përse në deklarimin fillestar është deklaruar si pasuri e paluajtshme mbi të cilën dispononte të drejta reale.

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi se<sup>11</sup>, *nuk disponon kontratë porosie apo dokument tjetër shkresor për apartamentin e sipërcituar. Në muajin tetor 2003 shitësit i është likuiduar shuma e dakordësuar prej 1,000,000 lekësh dhe se ky apartament ka qenë në përdorimin e tij me qira që prej muajit prill 1998 e në vijim. Arsyeja që në deklarimin fillestar është deklaruar si pasuri e paluajtshme, është fakti se për këtë pasuri ishte paguar pagesa për blerjen që në tetor të vitit 2003, për të cilën në atë kohë ishte bërë një deklaratë me shitësin ku pranonte pagesën e çmimit të shitjes dhe merrte përsipër detyrimin e kryerjes së transaksionit të kalimit të pronësisë. Porse për shkak të kohës së gjatë të kaluar si edhe faktit që është nënshkruar kontrata e shitjes me shitësin për banesën e sipërcituar, nuk e disponon këtë deklaratë aktualisht.*

Lidhur me mospërputhjen në deklarimin e vlerës së këtij apartamenti janë deklaruar: (i) vlera 2,000,000 lekë në deklaratën fillestare të pasurisë; dhe (ii) vlera 1,000,000 lekë në deklaratën *Vetting* (çmim i pasqyruar edhe në kontratën e shitblerjes), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi se<sup>12</sup>, *vlera reale e blerjes së apartamentit është ajo e pasqyruar në kontratën e shitjes prej 1.000.000 lekësh, deklaruar prej tij edhe në sqarimet e detajuara të dhëna pranë ILDKPKI-së në datën 24.7.2015, gjatë shpjegimeve të kërkuara, si edhe e rikonfirmuar në deklaratën “Vetting”. Diferenca prej 1.000.000 lekësh me çmimin e deklaruar në deklarimin fillestar i referohet shpenzimeve të kryera prej tyre në pagesën e qirasë dhe restaurimin/mobilimin e pjesës ekzistuese dhe shtesës si edhe, ...në mungesë të udhëzimeve të qarta për mënyrën e plotësimit të këtij deklarimi, ka deklaruar tërësinë e shpenzimeve të kryera prej familjes së tij në lidhje me këtë banesë.*

<sup>9</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2019.

<sup>10</sup> Kontratë shitblerjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2004.

<sup>11</sup> Përgjigja e pyetjes nr. 1, nënpyetja (i), pyetësi nr. 2.

<sup>12</sup> Përgjigja e pyetjes nr. 1, nënpyetja (ii), pyetësi nr. 2.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti në ILDKPKI konstatohet se në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, subjekti rivlerësimi së bashku me me shtetasit A. Sh., L. U., F. B., P. Sh., H. Sh., dhe H. D., nëpërmjet formularit nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2006, kanë vetëdeklaruar për legalizim objektin informal shtesë anësore, në pallatin nr. \*\*\*, të ndodhur në rr. “\*\*\*”, Tiranë, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 46.6 m<sup>2</sup>.

Bazuar në aplikimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe banorët e tjerë të apartamentit, Drejtoria Rajonale e Aluiznit Tiranë ka nxjerrë lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 14.11.2011, ku përcaktohet: (i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore 46.6 m<sup>2</sup>; (ii) sipërfaqja e ndërtimit 46.6 m<sup>2</sup>; (iii) sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 238.9 m<sup>2</sup>; dhe (iv) për aktivitet, sipërfaqja 46.6 m<sup>2</sup>.

Duket se në datën 9.4.2012, në referim të lejes së legalizimit të sipërcituar, në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit apartament me sipërfaqe 60.6 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri, është rivlerësuar në datën 23.7.2013 në vlerën prej 11,574,600 lekësh dhe është paguar tatimi në vlerën prej 93,683 lekësh.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti ndër vite në ILDKPKI konstatohet se në deklarinimin fillestar të pasurisë por edhe në DPV-në e vitit 2004 nuk përmendet ekzistenca e shtesës anësore, e cila zotërohej nga subjekti i rivlerësimit, pasi ishte në funksion të pasurisë së blerë prej tij, si edhe nuk është deklaruar aplikimi i bërë për legalizimin e kësaj shtese në vitin 2006, leja e legalizimit e nxjerrë në vitin 2011 dhe regjistrimi i kësaj shtese në ZVRPP në vitin 2012.

Lidhur me këto konstatime, me dërgimin e prapësimeve pas rezultatetve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se, *nuk është kryer deklarimi veçmas i shtesës anësore në DPV-në e vitit 2004, pasi ashtu siç rezulton nga kontrata e shitjes me shtetasin H. Y., objekti i kontratës ka qenë i gjithë apartamenti si një i tërë, siç figuron edhe aktualisht. Kjo situatë ka qenë shkaktuar kryesisht edhe nga pasaktësitë dhe konfuzioni në regjistrat e ZVRPP, nga të cilat rezulton se apartamenti i sipërcituar ka qenë me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> (duke përfshirë dhe shtesën anësore) dhe në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes ky apartament rezulton me sipërfaqe 64.2 m<sup>2</sup>.*

Gjithashtu, ka shpjeguar se në dijeninë e tij në formularët e deklaratimeve periodike vjetore në ILDKPKI nuk ka pasur ndonjë seksion të veçantë ku mund të kryhej deklarimi për aplikimet pranë ALUIZNI-t apo leja e legalizimit dhe regjistrimi i kësaj pasurie, duke konsideruar faktin se kishte përmbushur detyrimin për ta deklaruar, pasi apartamenti është blerë si një i tërë së bashku dhe si i tillë është deklaruar.

Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me këtë pasuri, konstatohet se, bazuar në kërkesën e bërë nga subjekti i rivlerësimit në datën 17.2.2016 është bërë bashkimi i dy pasurive, pasurisë së llojit apartament me sipërfaqe 64.2 m<sup>2</sup> dhe pasurisë së llojit apartament me sipërfaqe 60.6 m<sup>2</sup> dhe se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes është regjistruar pasuria e llojit apartament banimi me sipërfaqe 124.8 m<sup>2</sup>.

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me shtesën anësore për momentin e ndërtimit dhe vlerën e saj, ndër të tjera, deklaroi se<sup>13</sup>, *nga banorët e tjerë të pallatit i është bërë*

---

<sup>13</sup> Përgjigja e pyetjes nr.1, nënpyetja (iv), pyetësori nr. 2.



*me dije se kjo shtesë është ndërtuar në vitin 1996 dhe se kjo shtesë ka qenë e përfunduar plotësisht para muajit prill të vitit 1998 – vit në të cilin ka filluar të banojë me qira në këtë apartament.*

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.1.1998; si dhe (ii) projektin e shtesës<sup>14</sup> të pallatit nr. \*\*\*, në rr. “\*\*\*\*” dhe preventivin e tij, në referim të të cilit duket se ky objekt është projektuar nga inxhinierët A. Sh. dhe B. F., në vitin 1996.

Referuar kontratës së shitjes së datës 20.1.1998 konstatohet se shtetasi H. Y. (babai i bashkëshortes së subjektit), ka blerë nga shtetasit A. Xh., dhe M. Xh., pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 110 m<sup>2</sup> (pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*), të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për vlerën prej 2,000,000 lekësh.

Pikërisht, në referim të kësaj kontrate ku parashikohet sipërfaqja e këtij apartamenti prej 110 m<sup>2</sup> subjekti deklaron se kjo vërteton faktin se shtesa anësore është ndërtuar përpara blerjes prej tij të kësaj pasurie, madje edhe para blerjes nga z. H.Y., babai i bashkëshortes.

Gjithashtu, edhe në kontratën e qirasë<sup>15</sup> të datës 18.9.1999 (depozituar nga subjekti) përcaktohet se në bazë të vërtetimit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, z. H. Y., figuron të ketë të regjistruar pasurinë e llojit apartament, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup> – të cilin ia lëshon me qira z. Artur Gaxhi për një periudhë kohe trevjeçare, afat ky që kishte filluar në datë 1.4.1998 dhe do të mbaronte në datë 1.4.2000, me qira mujore 10,000 lekë/muaj.

Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstatoi mospërputhje dhe pasqyrimë kontradiktore lidhur me regjistrimin dhe sipërfaqen e pronës në tërësi, në të cilën përfshihet dhe shtesa anësore.

Konstatohet se kontrata shitjes e vitit 1998 përcakton se kjo pronë me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> gjendet e regjistruar në zyrën hipotekore, me nr. regjistri \*\*\*, datë 15.7.1993, po ashtu edhe kontrata e qirasë përcakton se kjo pasuri prej 110 m<sup>2</sup> është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të qiradhënësit. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës së shitblerjes të vitit 2004 ka blerë nga babai i bashkëshortes pasurinë e llojit apartament me sip. 64.2 m<sup>2</sup>, pasi sikurse rezulton vetëm kjo pasuri (apartament) ishte e regjistruar në emër të këtij shtetasi në regjistrat hipotekore.

Gjithashtu, rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar shtesa anësore (si pasuri e llojit apartament) me sip. 60.6 m<sup>2</sup>, por referuar lejes së legalizimit sipërfaqja ndërtimore është 46.6 m<sup>2</sup> dhe nga verifikimi i dosjes së kësaj pasurie duket se ky apartament ndodhet në katin e pestë të këtij objekti (pallat 5-katësh).

Lidhur me këto konstatime, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, *procedurat e legalizimit janë ndjekur nga përfaqësuesit e banorëve të pallatit sipas projektit përkatës. Me aq sa konstatohet edhe nga dokumentacioni praktikës së lëgalizimit të shtesës anësore të pallatit, kati i parë i cili shërben si ambient shërbimi ka sipërfaqe 46.6 m<sup>2</sup> e pasqyruar si sipërfaqe ndërtimore, ndërsa 4 katet e tjera – ambient banimi kanë*

<sup>14</sup> Dokumenti shkresor i dorëzuar nga subjekti si projektit të kësaj shtese nuk përbën dokument zyrtar.

<sup>15</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.1999.

*sipërfaqe të përgjithshme prej 238.9. m<sup>2</sup>, pra, afërsisht 60 m<sup>2</sup> për secilin kat, pasi nga kati i dytë e lart apartamentet dalin me konsul.*

Subjekti ka depozituar si provë të re, 2 faqe nga raporti i rivlerësimit i bërë në datën 16.5.2013 mbi këtë pronë nga vlerësuesi “\*\*\*” sh.p.k., me porositës “Tirana Bank”. Nga këqyrja me sy të lirë e fotove të bëra mbi këtë pasuri, pjesë e këtij raporti, duket se sipërfaqja e shtesës anësore (apartamentit të ndodhur në katin e pestë të këtij objekti), e cila është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit është më e madhe se sipërfaqja ndërtimore, baza mbi të cilën është ngritur kjo shtesë, ose ndryshe kati zero i saj.

Nga analizimi në harmoni i të gjithë provave të administruara në dosje lidhur me këtë pasuri dhe vlerësimi me objektivitet dhe paanësi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se shtesa anësore ka qenë e ndërtuar para blerjes nga subjekti të apartamentit që lidhej me të.

Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti ka deklaruar saktë të dhënat mbi këtë/këto pasuri. Nisur nga ky fakt, por edhe për shkak të bindjes së krijuar se kjo pasuri është blerë dhe zotësuar si një e tërë nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2003, Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklaram janë pa pasoja dhe, si të tilla, nuk janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar. Në këtë kontekst, vlerësimi i këtyre pasaktësive merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive.

### **Analiza financiare e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

Në deklaratën fillestare të pasurisë, krahas kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar edhe pasuritë, si vijon: (i) autoveturë me vlerë 1,000,000 lekë, me burim krijimi kursimet prej të ardhurave nga pagat; (ii) llogari depozitë në emër të bashkëshortes në shumën prej 10,000 USD, me burim krijimi: (a) kursime nga pagat; dhe (b) pjesërisht dhuratë nga vëllai emigrant prej 10 vjetësh në Gjermani; dhe (iii) gjendje *cash*, në vlerën prej 9,000 USD, me burim krijimi puna në emigracion e vëllezërve të subjektit G. dhe A. Gaxha.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të specifikojë burimet e krijimit të likuideteve të deklaruara si gjendje *cash* si edhe të deklaruara dhe të evidentuara si gjendje në llogari bankare në datën 31.12.2003. Lidhur me këtë kërkesë të Komisionit subjekti i rivlerësimit deklaroi se,<sup>16</sup> *shuma e deklaruar nuk është e gjitha dhuratë nga vëllezërit... - këto shuma janë kryesisht kursime në vite të familjes së tij si edhe kontribute - dhurata të vëllezërve emigrantë jashtë shtetit. Shumat e dhuruara nga vëllezërit nuk i kujtohen saktësisht por se janë afërsisht 400,000 dhrahmi, të cilat janë depozituar prej bashkëshortes në bankë në vitin 1998.*

Në vijim, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se, *burimi i të ardhurave të vëllezërve ka qenë puna e tyre në emigracion. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk disponojnë dokumente që lidhen me punësimin e tyre janë shtetit...kjo edhe për shkak se ruajtja e dokumentacionit nuk ka qenë detyrim ligjor.*

Subjekti ka shpjeguar se në pamundësi të sigurimit të dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e përfituara nga puna në emigracion në shtetin grek, për shkak të kthimit të tij në

---

<sup>16</sup> Përgjigja e pyetjes nr. 8 – Pyetësori nr. 3.

Shqipëri që prej vitit 2001, vëllai i subjektit, z. G. G. (ish-emigrant në Greqi), i është drejtuar gjykatës në qytetin ku jetonte dhe punonte në atë kohë – gjykatë në të cilën ka bërë dëshmi me betim shtetasi grek G. D., duke deklaruar se z. G. G. ka banuar në Farsala që nga viti 1991 deri në vitin 1996 dhe ka punuar në punë të ndryshme. Pra, duket se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit (dëshmia me betim) nuk faktin të ardhura të përfituara nga puna në emigracion e vëllait të tij, z. G. G.

Subjekti nuk ka shpjeguar se sa ka qenë kontributi i vëllait të bashkëshortes së tij, në krijimin e depozitës prej 10,000 USD dhe për më tepër nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat (të pretenduara) e krijuara prej tij, si emigrant ekonomik në Gjermani. Si rrjedhim, në analizën financiare kjo shumë do të përfshihet e gjitha si pasuri e krijuar me të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes.

❖ Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1994 – 2003, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për blerjen e pasurisë së llojit apartament banimi, të ndodhur në rr. “\*\*\*”, Tiranë, të pasqyruar në tabelën, si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1994 - 2003</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat subjekti i rivlerësimit, periudha 1994 – 31.12.2003	3,282,460
Të ardhurat bashkëshortja e subjektit, periudha korrik 1996 – 31.12.2003	3,582,368
<b>Total të ardhurat</b>	<b>6,864,828</b>
Shpenzime qiraje, periudha prill 1998 – 2003	670,000
Shpenzime arredim mirëmbajtjeje <sup>17</sup>	350,000
Shpenzime për jetesë 1994 –1999 <sup>18</sup>	572,112
Shpenzime jetese për vitet 2000 – 2003, referuar ILDKPKI-së dhe INSTAT	1,211,484
<b>Total shpenzime</b>	<b>2,803,596</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklaruar (9,000 USD)	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim – gj. fund periudhe dokumentuar (bankë)	-1,158,929
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>2,902,303</b>
Blerë ap. banimi, rr. “***”, viti 2003 deklaruar pagesa	1,000,000
Pagesa për blerje autoveture 2001	1,000,000
<b>Total pasuri</b>	<b>2,000,000</b>
Detyrime 31.12.2003	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>2,000,000</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>902,303</b>

<sup>17</sup> Vetëdeklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

<sup>18</sup> Vetëdeklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4 (25% e të ardhurave).

Për sa më sipër, nga analiza financiare e kryer konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për blerjen e pasurisë së llojit apartament banimi, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*” Tiranë, për blerjen e pasurisë së llojit autoveturë, krijimin e depozitës bankare dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni dhe të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera deri në 31.12.2003.

Në këtë analizë nuk është përfshirë gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë – deklaruar me burim krijimi të ardhurat nga puna në emigracion e vëllezërve të subjektit, z. G. G. dhe z. A. G., për të cilat, paraprakisht, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e realizuara prej tyre në emigracion. Analiza e ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe mundësisë së përfshirjes apo jo në analizë financiare do të kryhet në vijim të këtij vendimi, në momentin që këto likuiditete *cash* do të evidentohen të përdorura si burim krijimi i ndonjë pasurie.

**27. Pasuria e llojit apartament banimi<sup>19</sup>, me sipërfaqe 180 m<sup>2</sup>**, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, i porositur<sup>20</sup> në vitin 2010 dhe i blerë<sup>21</sup> përfundimisht në vitin 2015, me vlerë 200,000 euro – në bashkëpronësi me bashkëshorten me nga 50 % secili.

Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) vlerën prej 120,000 euro kredi në “\*\*\*\*”, datë 11.2.2011; (ii) vlerën prej 41,000 euro nga shitja e apartamentit në Golem; (iii) vlerën 1,500,000 lekë nga shitja e autoveturës; dhe (iv) kursimet familjare.

#### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

Referuar DPV-së për vitin 2010, në rubrikën “*ndryshimet e interesave private pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme*”, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje<sup>22</sup> me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., për berjen e pasurisë së llojit apartament me sip. 180 m<sup>2</sup>, për vlerën 200,000 euro, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë – vlera e paguar në vitin 2010 në shumën prej 60,000 euro. Ndërsa, në rubrikën “*detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti ka deklaruar shumën e shlyer ndaj shoqërisë ndërtuese në vlerën prej 60,000 euro dhe gjendjen e detyrimit të mbetur në datën 31.12.2010, në shumën prej 140,000 euro.

Referuar DPV-së për vitin 2011 konstatohet se në rubrikën “*detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti ka deklaruar pagesën e kryer në favor të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën prej 120,000 euro – dhe detyrimin e mbetur në datën 31.12.2011, në shumën prej 20,000 euro.

---

<sup>19</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI): (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 12.2.2015 dhe kartela e pasurisë; (2) kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2010; (3) kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2011 + njoftim debitimi nga “Raiffeisen Bank”, datë 11.2.2011; (4) tre mandatarkëtime: (i) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 10.11.2010, (ii) mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 6.12.2010 dhe, (iii) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 25.9.2015; (5) deklaratë mirëbesimi mes palëve datë 20.1.2015; (6) kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2015; (7) kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2010; dhe (7) revokim kontrate sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.11.2010.

<sup>20</sup> Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2010.

<sup>21</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2015.

<sup>22</sup> Kontrata sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2010.

Gjithashtu edhe në DPVtë për vitet 2012, 2013 dhe 2014, në rubrikën “*detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese, në shumën prej 20,000 euro.

Në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën “*ndryshimi i pasurive*”, subjekti ka deklaruar kalimin në pronësi të pasurisë së llojit apartament të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 200,000 euro – duke deklaruar gjithashtu shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese në vlerën prej 20,000 euro, me burim llogaritë e mbyllura pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën prej 24,091.8 USD.

✓ Konstatohet se në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës prej 60,000 euro, të paguar brenda vitit 2010 si këst i parë për blerjen e kësaj pasurie.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

ZVRPP-ja Tiranë<sup>23</sup>, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament banimi me sipërfaqe 180 m<sup>2</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje (dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI) rezulton se nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes të datës 5.10.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë porositur nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe totale ndërtimi prej 180 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. E njëjta kontratë gjendet edhe në dosjen e kredisë bankare të marrë për këtë pasuri.

Referuar kësaj kontrate konstatohet se porositësi paguan çmimin në llogarinë e investitorit. Çmimi i apartamentit të porositur është 1,111 euro/ m<sup>2</sup> ose përafërsisht po të shumëzohet me sipërfaqen paraprake të apartamentit 180 m<sup>2</sup> \* 1,111 euro/ m<sup>2</sup> = 200,000 euro dhe nuk ndryshon pavarësisht nga lëvizjet e çmimeve. Këstet e pagesave do të ndjekin ecurinë e punimeve dhe do të ndahen në raportet si vijon, 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, pjesa tjetër e mbetur do të likuidohet me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZQRPP-në Tiranë<sup>24</sup> rezulton se pjesë e dosjes së regjistrimit të kësaj pasurie është edhe kontrata e sipërmarrjes e sipërcituar (me të njëjtat ekstremite) – por nga këqyrja e saj konstatohet se ndryshon përcaktimi që ka të bëjë me çmimin/ m<sup>2</sup> (1,000 euro/ m<sup>2</sup> – gjithsesi në llogaritje çmimi paraqitet 1,11/ m<sup>2</sup>) dhe mënyrën e likuidimit të çmimit – porse nuk ndryshon çmimi final i shitjes së kësaj pasurie. Në referim të kësaj kontrate plani i pagesave të çmimit prej 200,000 euro përcaktohet si vijon: (i) 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) 50% = 100,000 euro do të likuidohen me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit deri në muajin tetor të vitit 2010; dhe (iii) pjesa tjetër prej afro 20% = 40,000 euro do të likuidohet nga porositësi në momentin e dorëzimit fizik të apartamentit nga sipërmarrësi, që do të jetë shtatori i vitit 2011. Kontrata me këtë plan pagesash konfirmohet edhe nga noteri publik<sup>25</sup>, znj. D. K.

<sup>23</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2019.

<sup>24</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2018, pjesë e dosjes së ILDKPKI (Aneks 28).

<sup>25</sup> Dërguar si dokument, bashkëlidhur shkresës së depozituar nga noteri publik, znj. D. K., protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2019.

I pyetur lidhur me ekzistencën e dy kontratave me ekstremite të njëjta, por me ndryshime në përmbajtjen e tyre (konkretisht çmimi/m<sup>2</sup> dhe në planin e pagesave), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjerë, deklaroi se<sup>26</sup>, *kontrata e sipërmarrjes është përgatitur nga ana e noterës sipas specifikimeve që janë dakordësuar fillimisht me shoqërinë ndërtuese. Versioni fillestar i kontratës ka pasur planin e pagesave për të cilën ju referoheni në kopjen e dorëzuar në ZVRPP. Ndërkohë në të njëjtin moment, është finalizuar me shoqërinë ndërtuese, plani përfundimtar i pagesës siç është specifikuar në kontratën që është dorëzuar në ILDKPKI, si dhe bankës pranë të cilës është aplikuar për kredi. Ky është edhe versioni përfundimtar i kontratës, për të cilin me sa duket noterja për shkak ndoshta të një gabimi njerëzor apo pakujdesie të saj nuk ka bërë reflektimin e këtij finalizimi në kopjen e saj.*

Në vijim, subjekti shpjegon se, *kjo përforcohet edhe nga gabimet dhe pasaktësitë e kalkulimeve nga noterja në kopjen e dorëzuar në ZVRPP, ku specifikohet: “Çmimi i apartamentit të porositur është 1,000 euro/ m<sup>2</sup> ose përafërsisht po të shumëzohet me sipërfaqen paraprake të apartamentit 180 m<sup>2</sup> \* 1,111 euro/m<sup>2</sup> = 200,000 euro dhe nuk ndryshon pavarësisht nga lëvizjet e çmimeve”. Pra, lehtësisht konstatohet që është një lapsus ose pasaktësi e noterës gjatë formulimit, pasi çmimi përfundimtar i apartamentit dhe ai për m<sup>2</sup> është i njëjtë. Ky çmim i njëjtë rezulton të jetë shprehur dhe materializuar edhe në kontratën e shitjes të datës 23.1.2015.*

Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie të datës 23.1.2015, në nenin 6 të saj, me titull “*çmimi i shitjes*” përcaktohet se, *pala shitëse deklaroi se është plotësisht dakord që t’ia shesë palës blerëse pronën, pasuri e paluajtshme përshkruar në nenin 2 të kontratës me një çmim 200,000 euro. Ndërsa në nenin 7, të kësaj kontrate me titull “mënyra e pagesës” përcaktohet se, palët janë në dijeni dhe bien dakord që çmimi i shitjes i përshkruar në nenin 6 të kontratës është likuiduar totalisht, ndër vite, kjo referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2010.*

Organet ligjzbatuese kanë informuar se në emër të subjektit të rivlerësimit ka disa raportime të akteve noteriale – në datën 5.10.2010 sipas raportimeve të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka nënshkruar kontratë porosie për blerje apartamenti me çmim 200,000 euro edhe noteri publik, znj. D. K. ka raportur se në datën 23.1.2015, sipas kontratës nr. 92 rep., nr. 44 kol., subjekti i rivlerësimit ka blerë apartament, me çmim 200,000 euro, me përshkrimin: “*Pagesa është kryer me bankë në periudha të ndryshme deri në likuidimin total të saj. Pagesat kanë filluar që në datën 6.10.2010*”.

### **Analiza e pagesave të kryera dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie**

Referuar dokumentacionin – pjesë të dosjes së kësaj pasurie në ZVRPP-në Tiranë<sup>27</sup>, konstatohet se në datën 3.12.2010 është derdhur *cash* në llogarinë e shoqërisë ndërtuese në BKT shuma prej 60,000 euro me përshkrimin: “*Artur Gaxha derdh në llogari të shoqërisë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., për blerje apartamentu në rr. ‘\*\*\*’ dhe në datën 5.9.2011 është derdhur cash në llogarinë e shoqërisë ndërtuese në “BKT” shuma prej 20,000 euro me përshkrimin: “Artur Gaxha derdh në llogari të shoqërisë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., këst përfundimtar apartamentu Rr. \*\*\**”.

Në vijim të kryerjes së veprimeve verifikuese – hetimore, Komisioni i kërkoi “BKT”-së të konfirmojë nëse në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., (llogaria nr. \*\*\* në Euro) janë

<sup>26</sup>Përgjigja e pyetjes nr. 2, pyetësi nr. 2.

<sup>27</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2018, e ZQRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI (Aneks 28).

depozituar *cash* në datën 3.12.2010 vlera prej 60,000 euro dhe në datë 5.9.2011 vlera prej 20,000 euro. “BKT”<sup>28</sup>, na informon se nga verifikimet e kryera në lëvizjet e llogarisë së shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., në datat 3.12.2010 dhe 5.9.2011 – nuk rezulton të ketë transaksione të kryera si depozitime *cash* në shumat 60,000 euro dhe 20,000 euro.

Për më tepër, konstatohet se shoqëria ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., ka njoftuar ZVRPP-në Tiranë se mandatpagesat bankare të referuara më sipër, paraqitur si pagesa për kontratën e shitblerjes të lidhur me z. Artur Gaxha dhe znj. D. G., i përkasin një kontrate tjetër sipërmarrjeje me porositës të tjerë, për një tjetër objekt të ndërtuar nga shoqëria.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar që shoqëron shkresën e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., të depozituar në ZVRPP, si dhe shpjegimeve dhe provave të reja të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit<sup>29</sup>, konstatohet se në llogarinë e shoqërisë janë kryer depozituar *cash*: (i) në datën 21.1.2015 shuma prej 40,000 euro me përshkrimin e veprimit: “*Artur Gaxha likuidim kësti për apartamentin në Rr. \*\*\**”; dhe (ii) në datën 22.1.2015 shuma prej 40,000 euro me përshkrimin “*P. G. derdh në llogari për Artur Gaxha, likuidim kësti për blerje shtëpie*”.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti<sup>30</sup>, si dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së ZVRPP-së Tiranë, lidhur me këtë pasuri është administruar dokumenti – deklaratë mirebesimi mes palëve datë 20.1.2015 (e mbajtur në zyrat e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k.), në referim të të cilit, administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., z. P. G., deklaroi se: “*Deri në ditën e nënshkrimit të kësaj deklarate është marrë nga porositësi shuma prej 180,000 euro, nga të cilat 120,000 euro janë bërë me transfertë në ‘Raiffeisen Bank’, 30,000 euro janë depozituar cash në zyrën e shoqërisë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 10.11.2010, dhe 30,000 euro janë depozituar cash në shoqërinë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2010, ndërsa pjesën tjetër në shumën 20,000 euro, ka rënë dakord që ta presë porositësin deri në fund të muajit shtator 2015, por kontratën e shitblerjes duhet ta nënshkruajmë brenda muajit janar të vitit 2015. Shumën prej 20,000 euro të kontratës së sipërmarrjes biem dakord që do ta depozitojë nga gjendja e arkës në llogarinë bankare të shoqërisë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., në BKT, me mirëbesim por pa interes. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha deklaroi se: “*Është dakord për çfarë shkruhet më lart dhe se e njëjta detyrimin e borxhit në shumën prej 20,000 euro dhe se do t’ia kthej z. P. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., brenda muajit shtator 2015.*”*

Në analizë të dokumentacionit të mësipërm dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, duket se për efekt të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në vitin 2015, krahas shumës prej 120,000 euro që ishte e evidentuar si e transferuar nga llogaria e bashkëshortes së subjektit, shoqëria nëpërmjet këtyre dy pagesave ka formalizuar pagesën e çmimit të plotë të shitblerjes së kësaj pasurie, nga të cilat 60,000 euro të paguara nga subjekti me nënshkrimin e kontratës dhe 20,000 euro të marra përsipër nga shoqëria – të paguara në vijim nga subjekti, brenda vitit 2015.

Konstatohet se pjesë e dosjes së kësaj pasurie është dhe dokumenti nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., – sipas të cilit në datën 11.2.2011

<sup>28</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020, e BKT-së.

<sup>30</sup> Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka transferuar në kësaj shoqërie shumë prej 120,000 euro, me përshkrimin: “D. blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.”.

Gjithashtu, pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI për këtë pasuri janë, (1) mandatpagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 10.11.2010, për kryerjen e pagesës prej 30,000 euro e përshkrimin: “*likujdim kësti për apartamentin në rr. \*\*\**”; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 6.12.2010, për kryerjen e pagesës prej 30,000 euro me përshkrimin: “*likuidim kësti për apartamentin në rr. \*\*\**”; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 25.9.2015, për kryerjen e pagesës prej 20,000 euro me përshkrimin: “*likujdim kësti për apartamentin e prenotuar në rr. \*\*\**”; si dhe (2) dokument nga “Raiffeisen Bank” – sipas të cilit konfirmohet se në datën 11.2.2011, znj. D. G., ka urdhëruar kalimin e shumës prej 120,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin: “*blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë*”.

I pyetur nga Komisioni lidhur me mënyrën e kryerjes së pagesave për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se,<sup>31</sup> *ato përputhen plotësisht me çfarë ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion përkatës në ILDKPKI, si në deklarin periodik ashtu edhe në deklarin Vetting. Të gjitha pagesat janë kryer prej tij cash pranë zyrës së shoqërisë dhe i vetmi veprim pagese i kryer nëpërmjet bankës është kalimi i shumës së kredisë nga llogaria e bashkëshortes së tij në ‘Raiffeisen Bank’ në llogarinë e shoqërisë “Perxhola” sh.p.k., dhe se nuk ka kryer asnjë veprim depozitimi pranë sporteleve të BKT apo të ndonje banke tjetër në funksion të kësaj kontrate.*

Komisioni vëren se në referim të kontratës së sipërmarrjes të lidhur për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit – me nënshkrimin e saj (datë 5.10.2010) ka paguar shumë prej 60,000 euro. Megjithëse, Komisioni konstati “2 kontrata” me ekstremite të njëjta, por me ndryshime në përmbajtjen e tyre – në planin e pagesave, vërehet se është i njëjtë momenti i përcaktuar në to për pagesën e këstit të parë, e konkretisht:

a) *sipas kontratës së parë: këstet e pagesave do të ndjekin ecurinë e punimeve dhe do të ndahen në raportet, si vijon: 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, pjesa tjetër e mbetur do të likuidohet me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësi;*

b) *sipas kontratës së dytë: plani i pagesave të çmimit prej 200,000 euro përcaktohet si vijon: (i) 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës.*

**Për sa më sipër, bazuar në të dhënat e referuara në kontratën e sipërmarrjes për blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se kësti i parë në shumë prej 60,000 euro është paguar nga subjekti i rivlerësimit në momentin e nënshkrimit të kontratës në datën 5.10.2010.**

Me dërgimin e prapësimeve, Komisioni vlerëson se z. Artur Gaxha nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm pretendimin e tij se kësti i parë në shumë prej 60,000 euro është likuiduar nëpërmjet 2 pagesave më 10.11.2010 dhe më 6.12.2010 – në referim të dy mandatpagesave të depozituara prej tij.

<sup>31</sup> Përgjigje e pyetjes 2.1, nënpyetje (i), të Pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.



Sjellim në vëmendeje këtu se dokumenti mandatarkëtim (mandatpagesë) – të cilën subjekti e refron si provë kryesore në mbështetje të deklarimit të tij – nuk është dokument zyrtar i parashtypur nga shtypshkronja e letrave me vlerë dhe si i tillë nuk është dokument i njohur nga organet tatimore apo nga institucionet e tjera publike.

Rezulton e provuar se kësti i dytë është paguar nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e bashkëshortes së subjektit si pjesë e të ardhruave të përfituara nga kredia bankare.

Për sa më sipër, Komisioni u ndal në analizimin dhe vlerësimin e momentit të pagesës së këstit të fundit për blerjen e kësaj pasurie.

Siç u evidentua më sipër, në *“dy kontratat”* e sipërmarrjes kemi përcaktim të ndryshëm për pagesën e kësteve pas pagesës së këstit të parë dhe konkretisht:

a) *“në kontratën e parë”* parashikohet se - këstet e pagesave do të ndjekin ecurinë e punimeve dhe do të ndahen në raportet si vijon: 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, pjesa tjetër e mbetur do të likujdohet me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit;

b) *“në kontratën e dytë”* parashikohet plani i pagesave si vijon: (i) 30% = 60,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) 50% = 100,000 euro do të likuidohen me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit deri në muajin tetor të vitit 2010; dhe (iii) pjesa tjetër prej afro 20% = 40,000 euro do të likujdohet nga porositësi në momentin e dorëzimit fizik të apartamentit nga ana e sipërmarrësit, që do të jetë në shtator të vitit 2011.

Në kushtet kur, Komisioni vlerësoi se me nënshkrimin e kontratës u pagua shuma prej 60,000 euro nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rezulton e provuar se në datën 11.2.2011 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit është paguar shuma prej 120,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese – vlera e mbetur për t’u paguar në referim të çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes është në shumën prej 20,000 euro.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI konstatohet se në DPV-të për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 në rubrikën *“detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë *“\*\*\*”* sh.p.k., në shumën prej 20,000 euro. Ndërsa, në DPV-në për vitin 2015 ka deklaruar nënshkrimin e kontratës së shitblerjes për pasurinë e porositur nga shoqëria *“\*\*\*\*”* sh.p.k., si dhe pagesën e këstit të fundit në shumën prej 20,000 euro.

Deklarimet e bëra, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI mbështeten edhe nga deklarata e mirëbesimit e depozitur në ZVRPP nga shoqëria *“\*\*\*\*”* sh.p.k., si pjesë e dosjes së regjistrimit të kësaj pasurie.

Megjithëse në *“në kontratën e dytë”* përcaktohet se *pjesa tjetër prej afro 20% = 40,000 euro do të likuidohet nga porositësi në momentin e dorëzimit fizik të apartamentit nga sipërmarrësi, që do të jetë në shtator të vitit 2011*, dhe se gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *e ka marrë në dorëzim këtë pasuri në fund të vitit 2011*, trupi gjykues vlerësoi se pagesa e këstit të fundit është kryer në vitin 2015 – duke vlerësuar si provë të rëndësishme deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, në ILDKPKI në kuptim pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në harmoni me provat e tjera të pjesë e dosjes së regjistrimit të kësaj pasurie, si dhe në vlerësim të faktit se në praktikën e shitblerjeve të pasurive në përgjithësi pagesa

e kështit të fundit lidhet me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes dhe regjistrimin e pasurisë në regjistrat hipotekorë.

Si konkluzion, në analizë të dokumentacionit ligjor të administruar në dosje (kontratë sipërmarrje + kontratë shitblerje + dokumentacioni bankar i personit të lidhur + DPV-të vjetore të depozituara në ILDKPKI), shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se pagesat e kësteve për blerjen e kësaj pasurie janë kryer, si vijon:

- pagesa e kështit të parë, në shumën 60,000 euro, është kryer në datën 5.10.2010;
- pagesa e kështit të dytë, në shumën 120,000 euro, është kryer në datë 11.2.2011;
- pagesa e kështit të tretë, në shumën 20,000 euro, është kryer brenda vitit 2015.

### **Analiza e burimive që kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë**

#### ***i. Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Golem, Durrës, në vlerë 41,000 euro***

Referur DPV-së për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pasurisë së llojit apartament me sip. 72 m<sup>2</sup>, për vlerën prej 45,000 euro, të ndodhur në Golem, Durrës. Konstatohet se kjo pasuri është porositur<sup>32</sup> nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 – deklaruar në DPV-në e vitit 2007.

Rezulton se referuar dokumentit “revokim kontratë sipërmarrje”<sup>33</sup> të datës 4.11.2010, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e investitorit dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositësit deklarojnë revokimin e kontratës së sipërmarrjes të datës 27.6.2006, e cila lidhet me prenotimin e pasurisë së llojit apartament banimi me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup> të ndodhur në Golem, Durrës, – duke kthyer çdo gjë në gjendjen e mëparshme. Referuar këtij dokumenti, porositësit i kthehet shuma e dhënë dhe investitorit i vihet në dispozicion prona, të cilën ka të drejtë t’ia pretoj për shitje kujtdo personi fizik a juridik<sup>34</sup>.

Po në këtë dokument është referuar vlera e kësaj pasurie prej 41,000 euro edhe plani i pagesave sipas kontratës së prenotimit të datës 27.6.2006, si vijon: (i) me nënshkrimin e kontratës është paguar shuma prej 25,000 euro; (ii) shuma prej 10,000 euro do të jepej deri në datë 25.9.2006; dhe (iii) shuma tjetër prej 6,000 euro do të shlyhej me dorëzimin e apartamentit.

Pra, meqënëse në kontratën e revokimit përcaktohet se investitorit ti vihet në dispozicion prona, duket se nga ana e porositësit është kryer pagesa e plotë prej 41,000 euro për këtë pasuri në referim të kontratës së sipërmarrjes – në konsideratë të faktit se pagesa e fundit do të kryhej me dorëzimin e apartamentit. Si rrjedhim, duket se me nënshkrimin e kësaj kontrate revokimi subjektit i është kthyer nga shoqëria shuma e plotë prej 41,000 euro.

Për sa më sipër, bazuar në dokumentin “revokim kontratë sipërmarrje”, datë 4.11.2010, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti në përgjigje të pyetsorit nr. 2 – shuma prej 41,000 euro është kthyer nga shoqëria dhe është marë në dorëzim nga subjekti në datën 4.11.2010.

Por në referim të kontratës së sipërmarrjes, pagesa e kështit të parë në shumën prej 60,000 euro është kryer në momentin e nënshkrimit të saj, pra, në datën 5.10.2010. Si rrjedhim, Komisioni

<sup>32</sup> Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.6.2020 (depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve).

<sup>33</sup> Dokumenti noterial nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.11.2010.

<sup>34</sup> Konfirmuar kjo marrëdhënie nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, (pyetje 8.1).

vlerëson se shuma prej 41,000 euro nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e kësaj pasurie.

## **ii. Të ardhurat nga shitja e autoveturës në shumën 1,500,000 lekë**

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 7.5.2010 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka shitur<sup>35</sup> pasurinë e llojit autoveturë tip “Suzuki-Vitara”, për vlerën prej 1,500,000 lekësh – shumë e cila sipas deklarimit është likuiduar përpara lidhjes së kontratës – jashtë zyrës noteriale.

Referuar DPV-së për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit autoveturë, tip “Suzuki-Vitara”, në emër të bashkëshortes në vlerën 3,000 euro, pasuri e krijuar në shtator të vitit 2004. Ndërsa referuar DPV-së për vitin 2010 konstatohet se subjekti ka deklaruar shitjen e pasurisë së llojit autoveturë, tip “Suzuki-Vitara”, në vlerën prej 1,500,000 lekësh.

DPSHTRr-ja<sup>36</sup>, ka vënë në dispozicion dosjen e plotë të këtij automjeti nga verifikimi i të cilës konstatohet se: (i) në datën 26.9.2004 ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit në shumën prej 2,700 euro; (ii) në datën 20.5.2005 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjete dhe është paguar detyrimi doganor në shumën prej 226,377 lekësh; (iii) po në datë 20.5.2005, subjekti i rivlerësimit ia dhuron<sup>37</sup> këtë automjet bashkëshortes; dhe (iv) në datën 7.5.2010, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e shet këtë automjet në vlerën 1,500,000 lekë.

*Shuma e deklaruar, si e përfituar nga shitja e kësaj pasurie, është deklaruar si burim krijimi i pasurisë së llojit apartament banimi, objekt hetimi.*

Në konsideratë të faktit se ky automjet është shitur me një çmim më të lartë se ai i blerjes + shpenzimeve të zhdoganimit, pasi është përdorur mbi 5 vjet nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij – Komisioni ngre dyshime të arsyeshme lidhur me vlerën reale të shitjes së kësaj pasurie në vitin 2010.

Për më tepër, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, nuk evidencohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat<sup>38</sup>, për të ardhurat e realizuara prej bashkëshortes së subjektit nga shitja e kësaj pasurie. Si rrjedhim, në analizën paraprake financiare nuk u përfshinë të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja në datën 7.5.2010 të pasurisë së luajshme automjetit tip “Suzuki- Vitara”.

Në vlerësim të shpjegimeve përfundimtare të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, trupi gjykues çmoi se vlera totale e shpenzuar nga subjekti për këtë automjet është rreth 750,000 lekë, ku përfshihet: çmimi fillestar i blerjes; pagesa e kryer për zhdoganim; dhe shpenzimet e transportit/regjistrim/targim. Në këtë kuptim, Komisioni vlerësoi se në analizën financiare do të përfshihet si vlerë e përfituar nga shitja e këtij automjeti prej subjektit të rivlerësimit/personit të lidhur shuma prej 750,000 lekësh. Pra, nuk do përfshihet shuma e plotë prej 1,500,000 lekësh, pasi për të ardhurat shtesë të realizuara/përfituara të pretenduara nga shitja e këtij automjeti, në shumën prej rreth 750,000 lekësh, nuk u dokumentua pagesa e detyrimeve tatimore.

## **iii. Kursime të tjera familjare**

<sup>35</sup> Kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2010.

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020.

<sup>37</sup> Kontrata e dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.5.2005.

<sup>38</sup> Nuk u provua shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore për fitimin e rezultuar [çmim shitje –(çmim blerje+shpenzime të tjera )].

Referuar dekaratës fillestare të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve në formë kursimesh *cash*, shumën prej 9,000 USD, me burim krijimi të ardhurat nga puna në emigracion e vëllezërve të tij, z. G. G. dhe z. A. G.

Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. G. G. dhe z. A. G. bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

Në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të vëllezërve të tij, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë/dhuruar prej 9,000 USD, deklaruar prej tij si pasuri në formë likuiditetesh *cash* në deklarinimin fillestar të pasurisë.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se vëllai i tij, z. G. G., ka qenë pjesë e familjes së tij (e referuar edhe në trungun familjar) për periudhën 2001 – tetor 2003. Në konsideratë të këtij fakti, subjekti pretendon të përfshihet në analizën financiare të mundësisë së krijimit të shumës prej 9,000 USD të ardhurat e përfituara nga vëllai i tij, z. G. G., nga puna e kryer pranë shoqërsë “Telekom Albania” (ish-AMC), për periudhën pas emigracionit dhe konkretisht për vitet 2001–2003. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si prova: (i) çertifikatë familjare – e cila tregon gjendjen në datën 24.2.2004; si dhe (ii) deklaratën e datës 30.10.2019 nga “Alpha Bank”.

Referuar deklaratës së datës 30.10.2019 të lëshuar nga “Alpha Bank”, vërtetohet se z. G. G. është klient i kësaj banke, të cilit i ka kaluar paga e kompanisë AMC për periudhën 2001 – 2003, si vijon: (i) për vitin 2001 është kredituar në llogari vlera 196,278 lekë; (ii) për vitin 2002 është kredituar në llogari vlera 709,963 lekë; dhe (iii) për vitin 2003 është kredituar në llogari vlera 703,053 lekë.

Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara prej vëllait të tij, z. G. G., nga puna në emigracion, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe në prapësimet përfundimtare të dërguara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pranuar mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar realizimin e këtyre të ardhurave, duke pretenduar pamundësinë e sigurimit të dokumentacionit në kushtet kur ka kaluar një periudhë e gjatë kohë – prej momentit kur vëllai i tij ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek, duke paraqitur si provë të vetme dokumentin “dëshmi me betim” të datës 21.11.2018 bërë në gjykatën e Paqit, Farsala, Greqi, nga shtetasi grek G. D..

Referuar kësaj dëshmie, shtetasi grek G. D. ka deklaruar se z. G. G. ka jetuar dhe banuar në Farsala nga viti 1991 deri në vitin 1996 dhe punonte në punë të ndryshme.

Ndërsa, për vëllain tjetër, z. A. G., nuk ka dhënë asnjë shpjegim dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhura të krijuara prej tij në emigracion të cilat pretendohen se kanë shërbyer si burim krijimi i një pjese të shumës prej 9,000 USD, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si gjendje likuiditetesh *cash* në deklarinimin fillestar të pasurisë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, si dhe shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur si burim krijimi i shumës prej 9,000 USD janë deklaruar ta ardhurat nga emigracioni i dy vëllezërve (pa u përcaktuar pjesa takuese e tyre), të ardhurat e përfituara nga vëllai i tij, z. G. G. prej punës së kryer në shoqërinë

“Telekom Albania” (ish-AMC) – nuk do përfshihen si të ardhura të mundshme për krijimin e shumës prej 9,000 USD.

Ndërsa, dokumenti “dëshmi nën betim” (i depozituar si provë nga subjekti i rivlerësimit) nuk referon të ardhura të krijuara nga puna e vëllait të tij në emigracion.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 9,000 USD, deklaruar prej tij në formë kursimesh *cash* në deklaratën fillestare të pasurisë. Si rrjedhim, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare.

Për më tepër, vërehet se në referim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, personat e tjerë të lidhur, dy vëllezërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë konfirmuar mardhënien e dhurimit. Subjekti nuk ka depozituar deklarata noteriale të vëllezërve të tij – për të konfirmuar deklarimin e bërë prej tij në deklaratën fillestare të pasurisë. Në këtë këndvështrim – të dhënat e referuara në deklaratën fillestare të pasurisë, lidhur me dhurimin e shumës prej 9,000 USD nga vëllezërit e tij, mbeten të karakterit deklarativ.

Në vijim të verifikimit të kursimeve të deklaruara nga subjekti, ndër vite, Komisioni vëren se referuar DPV-së së vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga gjendjen *cash* në shumën 600,000 lekë. Ndërsa referuar DPV-së së vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si kursime gjendjen *cash* në shumën 300,000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit deklaroi dy depozita bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të fëmijëve (përkatesisht nga 1,700 euro), me burim: grumbulluar dhurata, kursime, ditëlindje (që nga lindja e vajzës).

Për sa i përket kursimeve të deklaruara si gjendje *cash* në vitet 2006 dhe 2007, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni konstatohet se viti 2006 rezulton me balancë negative fondesh – si rrjedhim duket se subjekti nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin e shumës prej 600,000 lekësh të deklaruar për këtë vit si kursime në gjendje likuiditetesh *cash*.

Gjithashtu, në konsideratë të faktit se në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy depozita në emër të fëmijëve me vlerë totale 3,400 euro me burim krijimi edhe kursimet e mbartura (duke mosspecifikuar vlerën e pakësuar), duket se edhe shuma prej 300,000 lekësh deklaruar e kursyer në vitin 2007 (vit i cili paraqitet me balancë pozitive fondesh), nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*”, Tiranë.

Lidhur me këto konstatime, subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e nuk janë bindëse dhe se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Analiza financiare e vitit 2006, e cila ka rezultuar me balancë negative fondesh, si dhe vlerësimi i shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatin e dërguar nga Komisioni, do të paraqitet në mënyrë të detajuar në vijim të këtij vendimi në vlerësimin/analizimin e kryer për pasuri të tjera të krijuara gjatë vitit 2006<sup>39</sup>.

<sup>39</sup> Si pasuri kryesore e krijuar gjatë këtij viti, pasuria e llojit apartament banimi, e ndodhur në Golem.

- ❖ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimin e prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pas verifikimit të burimeve financiare të deklaruara për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2010 - 5.10.2010, të pasqyruar në tabelën, si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 5.10.2010</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit, referuar “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank” për periudhën	872,672
Të ardhurat nga paga të bashkëshortes së subjektit, referuar “Raiffeisen Bank”	1,469,945
Të ardhura të tjera, nga shitja e automjetit tip “Suzuki-Vitara”	750,000
Të ardhura financiare (interesa)	41,577
Depozitim nga A. Z., datë 8.9.2010	150,615
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>3,284,809</b>
Kontribut për pension suplementar subjekti, “Raiffeisen Bank”	9,000
Kontribut për pension suplementar bashkëshortja, “Raiffeisen Ban”	9,000
Shpenzime për kredi periudha 1.1.2010 - 26.7.2010, “Raiffeisen Bank”	321,182
Shpenzime për “Cambridge Arts &Scientes”, për djalin K. G, datë 16.6.2010 (1,530 GBP)	247,034
Shpenzime për telefoni celulare, sipas “Raiffeisen Bank”	44,200
Shpenzime për sigurim privat shëndeti Sigal (1.1.2010 - 5.10.2010)	12,400
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi)	243,958
Shpenzime për jetesë për 9 muaj INSTAT, ILDKPKI	409,860
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>1,296,634</b>
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklaruar	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe dokumentuar	- 1,563,163
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>425,012</b>
Pagesë kështi, për blerje apartament te shoqëria “****” sh.p.k., shuma 60,000 euro (pagesë e kryer në datë 5.10.2010), referuar kontratës së sipërmarrjes.	8,293,800
<b>Total pagesë pasuri e paluajtshme (2)</b>	<b>8,293,800</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>- 7,868,788</b>

- ↓ Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., krijimin e pasurive të tjera, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2010 – 5.10.2010.

#### Analiza e burimit të pagesës së kështit të dytë në shumën prej 120,000 euro

“Raiffeisen Bank”<sup>40</sup> konfirmon se nëpërmjet kontratës së kredisë bankare dhe hipotekore<sup>41</sup> të datës 4.2.2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë përfituar kredi në shumën prej 120,000 euro, me qëllim përdorimin e tyre për blerje shtëpie<sup>42</sup>.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2019.

<sup>41</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2011.

<sup>42</sup> Referuar nenit 1, të kësaj kontrate.

Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” (nr. 8001017429 në euro), llogari në të cilën është *disbursuar* kredia e sipërcituar, konfirmohet se në datën 11.2.2011 është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 120,000 euro. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit lidhur me pagesën e këstit të dytë dhe burimin e krijimit të saj – që ka shërbyer për blerjen e pasurisë objekt hetimi.

### **Analiza e burimit të pagesës së këstit të tretë në shumën prej 20,000 euro**

Në shqyrtim të prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me momentin e pagimit të këstit të tretë, pasi u vlerësuan me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, trupi gjykues krijoi bindjen dhe arriti në përfundimin se pagesa e këstit të tretë për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, është kryer gjatë vitit 2015.

Në referim të analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme të cilat justifikojnë plotësisht pagesën e këstit të fundit për blerjen e kësaj pasurie.

**28. Pasuri e llojit garazh<sup>43</sup>, me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>**, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, i blerë<sup>44</sup> në vitin 2014, me vlerë 3,325,000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten me nga 50 % secili. Subjekti, si burim krijimi të kësaj pasurie, ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Referuar DPV-së për vitin 2014 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit garazh, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Tiranë, me vlerë 3,325,000 lekë.

*Konstatohet se në DPV-në e vitit 2014 subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.*

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

ZVRPP-ja Tiranë<sup>45</sup>, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit garazh, me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>.

Rezulton se nëpërmjet kontratës së shitblerjes së datës 5.6.2014 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë këtë pasuri nga shtetasi A. R., për vlerën prej 3,325,000 lekësh – cila sipas palës shitëse është likuiduar totalisht.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *pagesa për blerjen e garazhit është kryer cash para nënshkrimit të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 5.6.2014. Mjetet monetare janë tërhequr nga llogaria e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, datë 29.5.2014.*

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar konfirmohet se në datën 29.5.2014 nga llogaria në valutë e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” është tërhequr shuma prej 26,200 euro.

✓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie.

<sup>43</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI): (1) çertifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 26.4.2014 + kartelën e kësaj pasurie; (2) kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2014; (3) çertifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 17.11.2011 + kartelën e pasurisë; (4) mandate tërheqje nga llogaria në “Raiffeisen Bank”, datë 29.5.2014.

<sup>44</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2014.

<sup>45</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2019.

**29. Pasuri e llojit tokë<sup>46</sup>, me sip. 900 m<sup>2</sup>**, e ndodhur në fshatin Mjull Bathore, Tiranë, blerë në vitin 2014, me vlerë 2,000,000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten me nga 50 % secili. Subjekti si burim krijimi të kësaj pasuri ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; dhe (ii) kursimet familjare.

Referuar DPV-së për vitin 2014 konstatohet se subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë së llojit tokë arë me sip. 900 m<sup>2</sup>, për vlerën 2,000,000 lekë – pasuri e regjistruar në bashkëpronësi me bashkëshorten.

*Konstatohet se në DPV-në e vitit 2014 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.*

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

ZVRPP-ja Tiranë<sup>47</sup>, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit tokë arë me sip. 900 m<sup>2</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se nëpërmjet kontratës së shiblerjes të datës 29.1.2014, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e kanë blerë këtë pasuri nga shtetasit V. D., A. D., M. D., dhe E. D., të ndodhur në Mjull Bathore, Tiranë, për vlerën prej 2,000,000 lekësh – e cila sipas deklarimit të palës shitëse është likuiduar totalisht.

Si dokumentacion povues për burimin dhe kryerjen e pagesës në favor të palës shitëse subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin mandat tërheqje nga llogaria, sipas të cilit provohet se në datën 28.1.2014, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr shumën prej 15,000 euro nga llogaria e saj në valutë në “Raiffeisen Bank” (nr. 8001017429 në euro) – konfirmuar ky transaksion i kryer edhe nga verifikimi i kësaj llogarie bazuar në të dhënat e dërguara nga “Raiffeisen Bank” në kuadër të këtij hetimi administrativ të kryer nga Komisioni.

✓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie.

### **Analizë e burimit të krijimit të pasurive të llojit garazh dhe tokë arë të pasqyruara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi**

Siç u evidentua më sipër, për pasurinë e llojit garazh me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>, blerë në datën 5.6.2014, në vlerë 3,325,000 lekë dhe për pasurinë e llojit tokë arë me sip. 900 m<sup>2</sup>, blerë në datë 29.1.2014, në vlerë 2,000,000 lekë – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me sip. 210.3 m<sup>2</sup>, përfutur sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndarjen në përdorim personal dhe në pronësi të ambienteve të zyrave të shoqërisë, të blera me kredi të disbursuar nga “Tirana Bank” në emër të shoqërisë në datën 16.5.2008 – si dhe shtojcë kontrate, datë 6.10.2008. Pjesa e kredisë

<sup>46</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI): (1) çertifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 3.3.2014 + kartela e pasurisë + harta treguese; (2) kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2014; (3) çertifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 30.12.2013 + kartela e pasurisë + harta treguese e saj; (4) vërtetim toke për V. D., lëshuar nga Komuna Farkë dhe; (5) mandate tërheqje nga llogaria në “Raiffeisen Bank” datë 28.1.2014.

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2019.



së pashlyer do të ndahet në mënyrë të barabartë individualisht nga 50 % për çdo ortak, e përshkruar në vendimin e sipërcituar.

Gjithashtu, po në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti në shumën prej 450,000 euro. Ndërsa në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur ka deklaruar kredinë e *disbursuar* nga “Tirana Bank” për blerje të apartamentit me sipërfaqe 210.3 m<sup>2</sup> në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë (gjendja e detyrimit 175,250 euro).

Konstatohet se në DPV-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshortja, znj. D. G., zotëron 49 % të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me kapital themeltar 100,000 lekë.

Nga verifikimi i kryer në faqen e ëeb-it të QKB-së konfirmohet se, znj. D. G., ka qenë pjesë e ortakëve themelues të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me 49 % të kuotave të kapitali – themeluar me vendim gjykate, datë 3.3.2004, me objekt veprimtarie në fushën e ndërtimit dhe të tregtimit të materialeve të ndërtimit, importin dhe eksportin e tyre.

Rezulton se me kontratën e sipërmarrjes së datës 11.4.2008, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka porositur te sipërmarrësi shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 404 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për çmimin 599,360 euro. Referuar nenit 4 të kësaj kontrate, *porositësi ka të drejtë të marrë titullin e pronësisë së apartamentit vetëm pasi të ketë shlyer dhe kështu e fundit të çmimit të shitjes*. Ndërsa në nenin 5 të saj me titull “*kushtet dhe mënyra e shlyerjes së pagesës*” përcaktohet se shlyerja e cmimit do të bëhet nga porositësi sipas këtyre kushteve: (i) shuma prej 500,000 euro në kohën e nënshkrimit të kontratës; dhe (ii) shuma prej 99,360 euro me dorëzimin e apartamentit (pagesat do të shlyhen në nr. llogarie \*\*\* të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në “Bankën Popullore”).

Nëpërmjet kontratës<sup>48</sup> për kredi afatgjatë të datës 16.5.2008, lidhur ndërmjet “Tirana Bank” dhe shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k., (*kredimarrës*) dhe z. A. Z. dhe znj. D. G. si dorëzanës, banka jep te kredimarrësi një kredi në vlerën prej 450,000 euro, e cila do të përdoret për blerjen e apartamentit me sip. 404 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Referuar të dhënave të dërguara nga “Tirana Bank”<sup>49</sup> rezulton se në datën 22.5.2008 është *disbursuar* në llogarinë nr. \*\*\* në euro, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 170,000 euro (vlerë nga kredia). Në të njëjtën datë kjo shumë ka kaluar në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “*për blerje apartamenti me sip. 404 m<sup>2</sup>*”. Ndërsa pjesa tjetër e kredisë, në shumën prej 250,000 euro, është *disbursuar* në datën 7.10.2008 (pas shtojcës së kontratës për kredi afatgjatë, datë 6.10.2008, në të cilën është reduktuar vlera e kredisë nga 450,000 euro në 420,000 euro).

Në datën 7.10.2008 është transferuar në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 236,000 euro me përshkrimin “*për blerje rezidence*”. Gjithashtu, referuar të dhënave të dërguara nga “Intesa Sanpaolo Bank” konstatohet se nga llogaria e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., (nr. 3\*\*\* në euro) në datën 18.9.2008, është transferuar shuma 40,000 euro me përshkrimin “*\*\*\*\* te \*\*\* sh.p.k. për blerje rezidence*”.

Me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 10.1.2013, është vendosur që të ndahen për përdorim personal dhe në pronësi ambientet e blera për qëllim përdorimi zyra

<sup>48</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.5.2008.

<sup>49</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 31.05.2019.

për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në Tiranë në adresën rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\* i banimit, Tiranë, me pjesë takuese për secilin, si vijon: (i) ortakut A.Z. apartamenti me sip. 193.7 m<sup>2</sup>, kati i 12, i ndërtesës në krahun perëndimor; dhe (ii) ortakës D. G. apartamenti me sip. 210.3 m<sup>2</sup>, kati i 12 i ndërtesës, në krahun lindor të saj. Që nga ky moment secili ortak merr në përdorim dhe në pronësi ambientet si më sipërpërkthuar, fakt i cili do të reflektohet dhe në ndarjen në mënyrë të barabartë me nga 50 % të detyrimit të kredisë së mbetur që duhet të likuideojë secili prej ortakëve personalisht në “Tirana Bank”.

Referuar të dhënave të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë<sup>50</sup> konstatohet se nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk janë të pasqyruara saktësisht në evidencat ligjore financiare të periudhës 2008 – 2014 (bilancet/pasqyrat financiare), ngjarjet ekonomike të ndodhura. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vitet 2012, 2013 dhe 2014, rezulton se nuk janë të pasqyruara ngjarjet financiare të ndodhura pas vendimit të asamblesë së ortakëve të kësaj shoqërie në datën 10.1.2013 (i sipërcituar), për ndarjen për përdorim personal dhe në pronësi të ambienteve të blera për qëllim përdorimi zyra për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në Tiranë, secilit ortak, si dhe ndarjen në mënyrë të barabartë me nga 50 % të detyrimit të kredisë së mbetur që duhet të likuideojë secili prej ortakëve personalisht në “Tirana Bank”.

Shoqëria “\*\*\*\*”<sup>51</sup> sh.p.k., informon se këto ambiente nuk janë regjistruar si pasuri të shoqërisë në aktivet e saj, pasi sipërfaqja e kontraktuar deri në atë kohë nuk ka qenë e regjistruar pranë regjistrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe për këtë qëllim nuk mund të bëhej regjistrimi në QKR. Ajo është një kontratë porosie dhe nuk mund të regjistrohet te pasuritë e shoqërisë.

Ndërsa shoqëria “\*\*\*\*”<sup>52</sup> sh.p.k., informon se sipërfaqja e kontraktuar është vënë në përdorim të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në fund të vitit 2012.

Në vijim konstatohet se në datën 18.6.2013, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e shitblerjes - duke blerë<sup>53</sup> nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament me sip. 8.8 m<sup>2</sup> dhe pasurinë e llojit apartament me sip. 184.5 m<sup>2</sup>, për shumën prej 313,038 euro.

I pyetur nga Komisioni (pyetësi nr. 2), në lidhje me mënyrën e pagesës dhe se nga kush i është likuiduar shuma prej 313,038 euro shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se – *kjo shumë i është likuiduar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet kredisë bankare disbursuar nga “Tirana Bank” në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 6.5.2008 dhe nr. \*\*\* datë 16.5.2008, ndryshuar me shtojcë kontrate për kredi afatgjatë nr. \*\*\*, datë 29.9.2008 dhe nr. \*\*\*, datë 6.10.2008, ndryshuar me shtojcë kontratë për kredi afatgjatë \*\*\*, datë 16.2.2010, dhe nr. \*\*\*, datë 22.2.2010 (pasi qëllimi fillestar i porositjes së ambientit me sip 404 m<sup>2</sup> i cili përfshin edhe këtë apartament, ka qenë ambiente zyra për shoqërinë “\*\*\*\*”, në të cilën bashkëshortja ka qenë në cilësinë e ortakës).*

<sup>50</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.04.2019

<sup>51</sup> Shkresë e protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2019.

<sup>52</sup> Shkresa e protokolluar në Komision nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020.

<sup>53</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2013.

Për sa më sipër, pasuria e llojit apartament me sip. 184.5 m<sup>2</sup> + 8.8. m<sup>2</sup> (referuar kontratës së shitblerjes së sipërcituar) është pjesë e pasurisë me sip. 404 m<sup>2</sup> – të porositur me kontratën e sipërmarrjes të datës 11.4.2008, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe në deklaratimet e subjektit duket se shumë prej 313,038 euro (vlera që i përket pasurive të përfituara nga bashkëshortja e subjektit) i është likuiduar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me kredinë bankare të marrë dhe të shlyer me të ardhurat e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. – deri më 31.12.2012 në shumën 137,788 euro (313,038 euro – 175,250 euro).

Për sa më sipër, duket se shuma prej 137,788 euro përfaqëson kapitale *neto* (pasuri- detyrime), të përfituara nga individi/ortak i shoqërisë (pasuri të krijuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2008 – 2012), për të cilat subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur duhet të dokumentojë shlyerjen e detyrimeve përkatëse tatimore.

Pas kalimit të barrës së provës, me prapësimet e dërguara dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit pretendoi se shlyerja e detyrimeve tatimore për shumën prej 137,788 euro, në bazë të ligjit nr. 8438/1998 është detyrim i shoqërisë – duke shtuar në argumentet e tij se prej shtatorit të vitit 2014 bashkëshortja nuk ka asnjë të drejtë dhe detyrim ndaj kësaj shoqërie për shkak se është larguar prej saj duke shitur kuotat që zotëronte në këtë shoqëri.

Në vijim subjekti pretendon se në përputhje me dispozitat ligjore është përpiluar dhe nënshkruar aktmarrëveshja<sup>54</sup> e datës 20.6.2013 lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe ortakëve/aksionerëve të kësaj shoqërie. Referuar këtij dokumenti, ndër të tjera, përcaktohet se të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të asmblesë së ortakëve të datës 10.1.2013, sipas të cilit ortakja D. G. ka përfutur për përdorim personal dhe në pronësi sipërfaqen e banimit prej 210.3 m<sup>2</sup>, ndërsa ortaku A.Z. ka përfutur për përdorim personal dhe në pronësi sipërfaqen e banimit prej 193.7 m<sup>2</sup> – do të njihen, pranohen dhe paguhen nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pranë institucioneve tatimore në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me udhëzimet përkatëse.

Siç u evidentua më sipër, znj. D. G., ka qenë pjesë e ortakëve themelues të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke zotëruar 49 % të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie. Në vijim, rezulton se nëpërmjet kontratës<sup>55</sup> së datës 26.9.2014 personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka shitur kuotat e saj të kapitalit të cilat i zotëronte në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. (49% në vlerë nominale) aksionerit tjetër të kësaj shoqërie, z. A. Z., në shumën prej 49,000 lekë.

Nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga DRT-ja Vlorë<sup>56</sup>, rezulton se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\* për vitet 2005 – 2013 ka deklaruar fitim, por nuk ka shpërndarë dividend. Fitimi *neto* i deklaruar nga kjo shoqëri për këto vite paraqitet, si vijon: (i) për vitin 2005 në shumën prej 2,083,918 lekë; (ii) për vitin 2006 në shumën 112,487,045 lekë; (iii) për vitin 2007 në shumën prej 3,617,288 lekë; (iv) për vitin 2008 në shumën prej 4,384,517 lekë; (v) për vitin 2009 në shumën prej 558,268 lekë; (vi) për vitin 2010 në shumën prej 517,149 lekë; (vii) për vitin 2011

<sup>54</sup> Depozituar si provë e re – me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

<sup>55</sup> Kontratë shitblerje kuotash nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., 26.9.2014.

<sup>56</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2009.

në shumën prej 44,989 lekë; (viii) për vitin 2012 në shumën prej 166,337 lekë; dhe (ix) për vitin 2013 në shumën prej 35,822 lekë.

Referuar gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 33<sup>57</sup> (dispozita në fuqi për kohën kur është kryer transaksioni), të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ndër të tjera përcaktohet s: “ *Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes vendore, si dhe çdo subjekt tjetër, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, mban në burim tatimin, ...për pagesat...dividentët, përveç dividentëve të përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 34 të këtij ligji.* ”

Ndërsa në nenin 33/1, pika 1, të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar përcaktohet se: “*..shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III, të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do shpërndahet në formë dividenti.* ”

Në kuptim dhe zbatim të këtyre dispozitave, si dhe në referim të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin brenda datës 31 korrik të çdo viti duhet të depozitojnë pranë Degës së Tatimeve, vendimin e organit kompetent vendimarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë të kapitalit dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi. Tatimi mbi dividendin për llogari të organeve tatimore, duhet të derdhet nga shoqëria, brenda datës 30 korrik të vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividendit për përfituesit<sup>58</sup>.

Siç u evidentua më sipër, kjo pasuri fillimisht ka qenë investim i shoqërisë dhe është marrë në dorëzim/përdorim prej saj në vitin 2012. Por, nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që kjo pasuri të jetë pasqyruar si aktiv/investim në evidencat kontabël të shoqërisë.

Komisioni vlerëson se në momentin e ndarjes së kësaj pasurie (përfitimit të ortakëve nga ky aset i shoqërisë) sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të vitit 2013, bashkëshortja e subjektit në cilësinë e njërit prej ortakëve të kësaj shoqërie ka pasur dijeni të plotë për veprimet financiare/ligjore dhe kontabël të shoqërisë lidhur me investimin, përdorimin dhe ndarjen e kësaj pasurie

Në këtë kuptim, nisur nga fakti se kjo pasuri kaloi nga pasuri e shoqërisë – e ndarë në pronësi të ortakëve të shoqërisë (në kushte normale aktiviteti) dhe për të cilën shoqëria kishte kryer pagesën e plotë për këtë investim, trupi gjykues arrin në përfundimin se shuma përkatëse e paguar nga shoqëria (çmim blerje – detyrime të kredisë, në proporcion me kuotat e secilit ortak dhe ndarjen e kësaj pasurie) përbën kapitale *neto* të përfituara nga ortakët e kësaj shoqërie, për të cilat duhej të paguhej detyrimi përkatës tatimor.

<sup>57</sup> Dispozita në fuqi për kohën kur është kryer transaksioni.

<sup>58</sup> Pika nr. 5.6, e këtij Udhëzimi – në fuqi në kohën që është kryer ky transaksion.

Subjekti në prapësimet e tij ka pranuar detyrimin e pagesës së tatimit për pjesën e investuar nga shoqëria në këtë pasuri dhe të përfituar nga bashkëshortja e tij në cilësinë e ortakes së shoqërisë, por pretendon se i takon shoqërisë mbajtja dhe pagesa e tatimit përkatës.

Komisioni vlerëson se bashkëshortja e subjektit në cilësinë e ortakes ka pasur dijeni të plotë për përfitimin e një pjese të kësaj pasurie – të paguar me të ardhurat e shoqërisë dhe, si rrjedhim, ka pasur detyrimin për deklarimin dhe pagesën tatimit përkatës për kapitalet neto të përfituara.

Sigurisht, që deklarimi dhe pagesa e tatimit do të bëhej nëpërmjet shoqërisë në përputhje me vendimin e asamblesë të datës 10.1.2013, por duket se shoqëria asnjëherë nuk i ka deklaruar në evidencat kontabël pagesat e kryera për blerjen/krijimin e kësaj pasurie dhe as transferimin/kalimin e tij tek ortakët.

Në këtë kuptim, vlera e aktivitetit të përfituar (në shumën prej 313,038 euro) është në disporcion me shumën realisht të paguar nga individit ortak përfitues i asetit (shuma e shlyer e kredisë prej personit të lidhur në vlerën 175,250 euro).

Nga hetimi i kryer, nuk u vërtetua deklarimi dhe pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore – që rrjedhin nga vendimi i asmblesë të datës 10.1.2013. Sjellim në vëmendje këtu se të gjitha pagesat e detyrimeve tatimore në lidhje me tatimin në burim deklarohen, mbahen dhe paguhen nga shoqëria, por kjo nuk do të thotë që përjashtohen nga përgjegjësia ortakët e shoqërisë, pasi janë këta të fundit që kanë dijeni të plotë për aktivitetin financiar të shoqërisë.

▼ **Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo pasuri nuk përmbush kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit, ...pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.**

Në këtë këndvështrim, shuma prej 137,788 euro (313,038 euro vlera e pasurisë – 175,250 euro kredia e transferuar te ortaku D. G.), që përfaqëson kapitale *neto* të përfituara nga individit/ortak i shoqërisë dhe për të cilat nuk u dokumentua shlyerja e detyrimeve tatimore, nuk do të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

Në vijim, konstatohet se në datën 23.7.2013 personi i lidhur, znj. D. G., i shet<sup>59</sup> shtetasit E. P., pasuritë e llojit apartament me sip. 8.8 m<sup>2</sup> dhe 184.5 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rr. “\*\*\*”, Tiranë, për shumën prej 450,000 euro – e cila është likuiduar nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit, nr. 8001017429, në “Raiffeisen Bank”. Rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deri në datën 23.7.2013 (datë në të cilën ka shitur pasurinë e sipërcituar) – nuk ka paguar asnjë shumë për këtë apartament.

Me kontratën për kredi afatgjatë<sup>60</sup>, datë 4.9.2013, banka i jep kredimarrësit (personit të lidhur) kredi në shumën 175,250 euro, e cila do të përdoret për refinancim, mbyllje e ½ të limitit të kredisë me afat të “\*\*\*” sh.p.k., e përdorur për blerje zyresh.

Konstatohet se kredia e marrë nga personi i lidhur sipas kontratës së datës 4.9.2013, në shumën prej 175,250 euro, për shlyerjen e kredisë së shoqërisë – është shlyer në vitin 2014 me të ardhurat nga shitja e apartamentit (të ardhura të cilat janë përfituar përpara se kredia të akordohej).

<sup>59</sup> Kontrata me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.7.2013.

<sup>60</sup> Kontrata me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.9.2013.

Në dritën e këtyre fakteve, duket se blerja edhe shitja e kësaj pasurie është kryer, në fakt para akordimit të kredisë afatgjatë në “Tirana Bank”, e cila do të përdorej për rifinancimin (mbylljen e ½ të limitit të kredisë me afat të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., e përdorur për blerje zyresh). Madje, rezulton se në datën 24.12.2013 shuma prej 175,275 euro (pjesë e shumës të përfitur nga shitja e apartamenteve) është transferuar nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” – në llogarinë e saj në “Tirana Bank”, para *disbursimit* të kredisë individuale.

Rezulton se kredia për zj. D. G. në shumën prej 175,250 euro – me qëllim mbylljen e detyrimit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., është *disbursuar* në datën 31.3.2014. Në vijim, konstatohet se në datën 1.4.2014, nga znj. D. G. është shlyer plotësisht detyrimi i kësaj kredie me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve – referuar si më sipër.

Për sa më sipër, nga analizimi në tërësi i këtyre transaksioneve duket se për një periudhë të shkurtër kohore personi i lidhur – në mënyrë të dyshimtë ka përfitur të ardhura nga shitja e pasurive në shumën prej 450,000 euro, pa kryer asnjë pagesë paraprake për blerjen krijimin e tyre, si dhe pa u evidentuar/dokumentuar asnjë kontribut, ndër vite, në këtë shoqëri – përveç kuotës së kapitalit fillestar prej 49,000 lekë. E vetmja pagesë, në shumën prej 175,250 euro është kryer në vitin 2014 për shlyerjen e kredisë që lidhej me rifinancimin e detyrimeve të mbetura për krijimin/blerjen e kësaj pasurie nga ana e shoqërisë.

Gjithsesi, në konsideratë të burimit të deklaruar – nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurive të llojit garazh me sip. 25 m<sup>2</sup> të ndodhur në rr. “\*\*\*”, Tiranë dhe pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Mjull Bathore, Tiranë – pasuri të deklaruara si të blera me të ardhurat nga shitja e 2 apartamenteve në rr. “\*\*\*”, Tiranë.

**30. Pasuritë e llojit ambient shërbimi (zyrë), me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> + garazh<sup>61</sup>**, të paregjistruara në ZVRPP, porositur në vitin 2005, zyra me vlerë 54,150 USD, ndërsa garazhi me vlerë 10,000 USD – pasuri këto në bashkëpronësi me bashkëshorten me nga 50 % secili. Si burim krijimi të këtyre pasurive ka deklaruar të ardhurat dhe hua – referuar në të dhënat konfidenciale.

Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament me sip. 147 m<sup>2</sup> + dyqan 40 m<sup>2</sup> + garazh, me vlerë 134,150 USD, porositur me kontratën e sipërmarrjes<sup>62</sup> së datës 19.8.2005. Pjesa takuese: 100 %. Por, konstatohet se nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Nëpërmjet kësaj kontrate sipërmarrjeje, subjekti i rivlerësimit ka porositur te shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., pasuritë e llojit: (i) apartament me sipërfaqe 147 m<sup>2</sup>, në katin e nëntë të banimit me nr. \*\*\*, në kullën nr. \*\*\*, me përbërje tre dhoma, një guzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse; (ii) dyqan me sip. 40 m<sup>2</sup>; dhe (iii) garazh, me vlerë totale 134,150 USD – pasuri këto të ndodhura në blv. “\*\*\*”, Tiranë, në objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

<sup>61</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/5 dhe 4/17 në dosjen e ILDKPKI): (1) kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., datë 19.8.2005; (2) deklaratë lidhur për marrdhënie huamarrjeje, nga D. G. dhe N. P., datë 12.7.2005; (3) deklaratë nga N. P., datë 30.1.2016, për shlyerje të detyrimit të huasë dhe; (4) ekstrakt bankar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, për llogaritë e shtetasit N. P., për periudhën 1.1.2003 – 6.7.2009.

<sup>62</sup> Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., datë 19.8.2005.

Referuar kësaj kontrate, çmimi i është likuiduar plotësisht shoqërisë ndërtuese – apartamenti, dyqani dhe garazhi janë të përfunduar plotësisht – porositësi deklaron se ka marrë në dorëzim edhe çelësat e tyre dhe nuk ka asnjë pretendim për cilësinë e punimeve.

Në kontratën e sipërmarrjes nuk është përcaktuar çmimi për secilën pasuri – ndërsa në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se zyra/dyqani është blerë në shumën prej 54,150 USD dhe garazhi është blerë në shumën prej 10,000 USD.

Në rubrikën “*të dhëna konfidenciale*” në deklaratën e rivlerësimit kalimar “Vetting” (shtojca 2), subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura të përfituara si fitues i lotarisë amerikane shumën totale 500,000 USD, shuma *neto* pas pagesës së tatimit 335,000 USD; (ii) të ardhura të përfituara nga interesat bankar për periudhën mars 2005 – 31 dhjetor 2016 ,në shumën prej 18,789.45 USD; dhe (iii) hua prej një të afërmi në shumën prej 60,000 USD – përdorur për blerjen e apartamentit, dyqanit dhe garazhit, pasuri të ndodhura në Blv. “\*\*\*\*”, Tiranë.

### **Analizë e të ardhurave deklaruar si burim krijimi për blerjen e këtyre pasurive**

Siç u evidentua më sipër, subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit për blerjen e këtyre pasurive, të ardhurat dhe huan e deklaruar në seksionin “*të dhëna konfidenciale*”. Në rubrikën “*të dhëna konfidenciale*” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, hua të marrë prej një të afërmi të familjes, z. N. P., në shumën prej 60,000 USD, në datën 12.7.2005 dhe se kjo hua është përdorur për blerjen e apartamentit, ambientit të shërbimit dhe garazhit, pasuri këto të ndodhura në Blv. “\*\*\*\*”, Tiranë. Në vijim të deklarimit, subjekti ka shpjeguar se është likuiduar vlera totale e huas me dy këste, prej 30,000 USD secili, në dhjetor të vitit 2015 dhe në janar të vitit 2016.

Lidhur me këtë hua, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 12.7.2005 (shkresë e thjeshtë) e mbajtur mes shtetasit N.P. dhe bashkëshortes së tij – sipas të cilës personi i lidhur, znj. D. G., ka marrë hua nga shtetasi N. P. shumën prej 60,000 USD pa interes dhe se nuk është përcaktuar koha e kthimit të kësaj shume.

Referuar DPV-së për vitin 2005 konstatohet se në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti/personi i lidhur nuk kanë deklaruar si detyrim huan e marrë nga shtetasi N. P. Gjithashtu, konstatohet se në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në vijim nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk evidentohet të kenë deklaruar këtë hua dhe as detyrim e mbetur ndaj shtetasit Nefir Petritaj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje<sup>63</sup>, duket se deklarimi i kësaj huaje është bërë për herë të parë në “*procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë*”, të mbajtur në datën 24.7.2015, në ILDKPKI (pyetja nr. 8/1).

Pasi iu kalua barra e provës, me dërgimin e prapësimeve dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk është kryer deklarimi i huas ndaj shtetasit N. P. në DPV-në e vitit 2005 për shkak të neglizhencës – lidhur me faktin se dispononte mjete monetare për shlyerjen e këtij detyrimi, pasi kishte deklaruar shumën e përfituar nga lotaria “gërvisht dhe fito” në SHBA, shumë e cila e mbulonte disa herë këtë detyrim. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në momentin e parë që është pyetur nga inspektorët e ILDKPKI-së, e ka deklaruar

<sup>63</sup> Dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019, nga ILDKPKI-ja.

këtë fakt dhe ka paraqitur dokumentin përkatës – deklaratën e huas lidhur midis bashkëshortes dhe huadhënësit.

Trupi gjykues çmon se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti për mosdeklarimin e kësaj huaje në vitin 2005 – madje në dukje ato janë kontradiktore, pasi megjithëse pretendohet se shkak i mosdeklarimit të kësaj huaje në DPV-në e vitit 2005 është neglizhenca lidhur me faktin se dispononte mjete monetare të cilat mundësonin shlyerjen e saj (nga lotaria e fituar), nga ana tjetër për rreth 10 vjet nuk është deklaruar ekzistenca/shlyerje e huas – në konsideratë edhe të faktit se gjatë kësaj peridhe subjekti ka kryer investime të tjera në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Referuar nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nepunësve publike”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që të deklarojë brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri me 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare.

Komisioni vëren se në deklaratën periodike të vitit 2005 huaja e pretenduar në shumën prej 60,000 USD nuk është deklaruar si burim krijimi i ndonjë pasurie dhe, për më tepër, kjo hua e pretenduar nuk është deklaruar as si detyrim financiar.

Duket se kjo hua në shumën prej 60,000 USD është deklaruar për herë të parë në procesverbalin e datës 24.7.2015 të mbajtur nga ILDKPKI-ja – në përpjekje për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve financiare të cilat kanë shërbyer për blerjen në vitin 2005 të apartamentit, njësisë së shërbimit dhe garazhit, pasuri të ndodhura në blv. “\*\*\*”, Tiranë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me këtë marrëdhënie, Komisioni vëren se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e kësaj huaje në vitin 2005. Përgjatë viteve 2005 – 2014 nuk evidentohet asnjë gjurmë, provë direkte/indirekte apo indicie që të referojë ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje.

Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë kryesisht të karakterit deklarativ, pasi në referim të dispozitave ligjore ka pasur detyrimin të deklaronte pasuritë, burimin e krijimit të tyre dhe detyrimet financiare. Për më tepër, në kushtet kur huaja e pretenduar ka qenë në vlerë të konsiderueshme - nuk duket bindës shpjegimi i subjektit se mosdeklarimi i saj ka qenë për shkak të neglizhencës.

Nisur nga fakti se kjo hua nuk është deklaruar në vitin 2005 dhe se nuk dokumentohet ligjërisht si marrëdhënie e krijuar në vitin 2005, Komisioni vlerëson se shuma prej 60,000 USD (pretenduar si e marrë hua) të mos merret në konsideratë si burim krijimi i pasurive të paluajtshme apartament, ambient shërbimi dhe garazh, të blera në vitin 2005 nga subjekti i rivlerësimit.

Për më tepër, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në pëpjekje për të dokumentuar ligjshmërinë e burimeve financiare të huadhënësit të pretenduar ka depozituar domentacion i cili referon të dhëna bankare të tij, duke mos paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e këtyre vlerave monetare.

### **Pasuri të tjera krijuara/blera në vitin 2005**



Në DPV-në për vitin 2005 subjekti ka deklaruar edhe pasurinë e llojit apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Durrës, prenotuar sipas kontratë sipërmarrje datë 28.4.2005, me vlerë 26,000 euro. Pjesa takuese:100 %.

Rezulton se nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes<sup>64</sup> së datës 28.4.2005, subjekti ka porositur te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament A3, në katin e dytë të banimit të godinës nr. \*\*\*, me sip. 58.2 m<sup>2</sup>, në kompleksin turistik që kjo shoqëri po ndërtonte në Golem, Durrës. Referuar kësaj kontrate, vlera e apartamentit është 26,000 euro, nga e cila kësti i parë është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës në shumën 10,000 euro, ndërsa këstet e tjera deri në likuidimin e plotë të vlerës së apartamentit do të likujdohen brenda tre muajve në marrëveshje mes palëve.

Subjekti ka depozituar: (i) mandatpagesë, datë 8.6.2005, shuma 2,500 euro, me përshkrimin “*arkëtuar nga Artur Gaxhi për blerje apartamenti sipas kontratës*”; (ii) mandatpagesë, datë 13.10.2005, shuma 5,000 euro, me përshkrimin “*për blerje apartamenti Golem, Artur Gaxhi*”; (iii) mandatpagesë, datë 11.1.2006, shuma 2,500 euro, me përshkrimin “*për blerje apartamenti nga Artur Gaxha*”; dhe (iv) mandatpagesë nr. 60, datë 14.6.2006, shuma prej 5,000 euro, me përshkrimin “*u pagua Artur Gaxha kundrejt kontratës*”.

Megjithëse nëpërmjet depozitimit të këtyre mandatpagesave subjekti pretendon se ka paguar një pjesë të detyrimit ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2006, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 detyrime ndaj shoqërisë – pretenduar si shumë e paguar në vitin 2006 sipas mandateve 7,500 euro.

Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se pagesat kanë ndjekur ecurinë e punimeve dhe se në favor të shoqërisë gjatë vitit 2005 është paguar në total shuma prej 17,500 euro, nga të cilat: shuma 10,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës; shuma prej 2,500 euro në datën 8.6.2005; dhe shuma prej 5,000 euro në datën 13.10.2005, sipas mandatpagesave të depozituara.

Subjekti ka deklaruar se *për shkak të mungesës së procedurave dhe udhëzimeve të qarta përkatëse nga ILDKPKI-ja, veçanërisht në fillimet e procesit të deklarimit (si është DPV-në 2005), prej tij është deklaruar vlera e plotë e kontratës së sipërmarrjes – duke mosdeklaruar detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë sipërmarrëse, në funksion të kësaj kontrate.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>65</sup> të datës 24.8.2007, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi V. Y. deklarojnë se *për apartamentin në vlerë 26,000 euro nga z. A.Gaxha është likuiduar me nënshkrimin e kontratës në datë 28.4.2005, kësti i parë në shumën 10,000 euro. Këstet e tjera deri në likuidimin e plotë të vlerës së apartamentit do të likujdoheshin brenda 3 muajve në marrëveshje mes palëve. Këtë apartament, z. Artur Gaxha, e ka vënë në dispozicion të z. V. Y., pasi prej tij ka marrë shumën 32,000 euro dhe se, ky i fundit, ka të drejtë të nënshkruajë kontratë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe të përfitojë apartamentin pas regjistrimit në ZVRPP.*

<sup>64</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.4.2005.

<sup>65</sup> Deklaratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.8.2007.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *shuma prej 32,000 euro është marrë në cash prej tij. Kjo shumë është paguar e shtrirë në kohë gjatë vitit 2006 deri në datën 24.8.2007.*

Por, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI konstatohet se në DPV-në e vitit 2006 nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga/si rezultat i marrëdhënies së sipërcituar.

↓ **Pasi analizoi me objektivitete dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues çmon se në referim të kontratës së sipërmarrjes, deklaratës noteriale të datës 24.8.2007, si dhe në konsideratë të faktit se subjekti nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë në DPV-në e vitit 2005, shuma prej 26,000 euro është paguar e plotë prej tij brenda vitit 2005 në favor të shoqërisë ndërtuese dhe si e tillë do të pasqyrohet në analizën financiare të vitit 2005.**

Komisioni vëren se për të ardhurat shtesë (fitimet) në vlerë 6,000 euro (32,000 çmimi i shitjes - 26,000 euro çmimi i blerjes) të përfituara nga transferimi i të drejtave lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi pagesën e detyrimeve tatimore në referencë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Si rrjedhojë, shuma e të ardhurave shtesë – në vlerën prej 6,000 euro nuk u përfshi në analizën financiare të vitit përkatës.

Gjithashtu, nga hetimi administrativ i kryer në referim të bilanceve kontabël të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., (të dorëzuara në DRT-në Vlorë) rezulton se në llogaritë vjetore (gjendje financiare) për vitin 2005 – në detyrime të kërkueshme pas më shumë se një vit (ortakë) është vetëdeklaruar shuma 39,669,012 lekë (gjendje në datë 31.12.2005).

Pra, duket se ortakët e kësaj shoqërie A. Z. dhe D. G. (bashkëshortja subjektit) kanë dhënë hua/investuar në këtë shoqëri shumë e mësipërme. Kjo shumë duke iu referuar kuotave përkatëse në kapitalin e shoqërisë, do t'i korespondonte: (i) A. Z. shuma 20,231,196 lekë (51 %); dhe (ii) D. G. shuma 19,437,815 lekë (49 %).

I pyetur për këto të dhëna financiare të shoqërisë në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ndër të tjera, ka deklaruar se *bashkëshortja e tij, nuk ka investuar asnjë mjet monetar në funksion të veprimtarisë ndërtuese të kryer nga shoqëria “\*\*\*”. Siç rezulton nga vendimi i asamblesë së ortakëve, datë 24.5.2005, i gjithë investimi për ndërtimin që do të kryhej nga shoqëria “\*\*\*”, do të mbulohej vetëm nga ortaku mazhoritar A. Z., pikërisht për shkak të pamundësisë financiare të bashkëshortes së tij për të kontribuar në këtë investim. Gjithë vlera e deklaruar si detyrime të kërkueshme/ortak është investuar plotësisht në masën 100 % prej ortakut mazhoritar A. Z., sic edhe është dakortësuar në vendimin e asamblesë së ortakëve të sipërcituar. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume prej shtetasit A. Z. – sqaron se ky shtetas ka qenë ortak në shoqëri të tjera ndërtuese, për aktivitetin e të cilave ai ka përfituar pjesën takuese të fitimit, ka disponuar të ardhura familjare të realizuara nga shitja e pronave të ndryshme të familjes së tij, etj.*

Komisioni konstatoi se vendimi i asamblesë i datës 24.5.2005 i depozituar nga subjekti si provë gjatë procesit të hetimit administrativ nuk është shoqëruar me dokumentacionin përkatës për thirrjen e ortakëve për mbledhjen e asamblesë në datën 24.5.2005 (nëpërmjet shërbimit postar

letër rekomande), të parashikuara nga ligji nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” neni 57 , i ndryshuar, si dhe regjistrin e posaçëm të vendimeve të asamblesë, parashikuar nga neni 25, i statutit të shoqërisë.

Në këtë këndvështrim, në rezultatet e hetimit të dërguara subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfshiu në analizën financiare për vitin 2005 pjesën takuese të personit të lidhur të vlerësuar paraprakisht si e dhënë borxh/hua/investuar shoqërisë/në shoqëri, referuar përqindjes së koutave të zotëruara prej saj në kapitalin e shoqërisë.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prapësimeve të përcjella në Komision, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore publike, ndër të tjera, lidhur me këtë konstatim ka parashtruar se zotërimi në një përqindje të caktuar të kuotave të një shoqërie nuk nënkupton që huan shoqërisë duhet t’ia japin ortakët dhe për më tepër që çdo hua që japin ortakët për shoqërinë të jetë në proporcion të drejtë me zotërimin e kuotave të tyre në shoqëri. Gjithashtu, ka sqaruar se kjo mardhënie huaje është e ndarë nga aktiviteti i funksionimit të përditshëm të shoqërisë dhe se e gjithë shuma e huas është përballuar nga ortaku mazhoritar, z. A. Z.

➤ Për të provuar pretendimet e tij se mbulimi i huas është kryer 100 % nga ortaku mazhoritar, subjekti ka depozituar si prova të reja dokumentacionin shkresor, si vijon:

i) kontratën e investimit<sup>66</sup>, datë 15.4.2005 – referuar kësaj kontrate ortaku A. Z. ka marrë përsipër individualisht detyrimin që së bashku me persona të tjerë të kryejë investim për ndërtimin e një kompleksi banesash, jo më pak se tetë kate, me dy kate dyqan, përkundrejt lejes së ndërtimit të lëshuar në emër të tri shoqërive, njëra prej të cilave “\*\*\*\*” sh.p.k.;

ii) deklaratën noteriale<sup>67</sup>, datë 6.7.2020, të administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. – nëpërmjet kësaj deklarate z. A. Z. ka deklaruar se huaja e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2005 në shumën prej 39,669,012 lekësh është hua e dhënë prej tij në masën 100 % për aktivitetin fillestar të shoqërisë në reflektim të kontratës së investimit datë 15.4.2005 (nënshkruar prej tij në cilësinë e njërit prej investitorëve dhe pronarëve të truallit), si dhe vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 24.5.2005, në të cilin është vendosur dhe pranuar që financimi i aktivitetit të shoqërisë do të përballohej vetëm prej tij.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se si burim për financimin e kësaj huaje kanë qenë të ardhurat e z. A. Z., të përfituara nga: (i) aktiviteti i tij si ortak i shoqërisë “\*\*\*\*”; (ii) shitja e pasurive të paluajtshme të familjarëve të tij; (iii) qenia në cilësinë e pronarit në truallin ku do të kryhej investimi; si dhe (iv) huamarrje të ndryshme, ndër vite, duke depozituar si dokumentacion provues: (a) kopje të ekstraktit historik të shoqërisë “\*\*\*\*”; (b) kontratë<sup>68</sup> shitje pasurie të paluajtshme, datë 22.8.2001; (c) vërtetim nga dokumenti hipotekor<sup>69</sup>, datë 10.2.2002, lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë; (ç) kontratë<sup>70</sup> blerje trualli, datë 15.4.2005; dhe (d) deklaratë<sup>71</sup> noteriale e shtetasve A. Z. dhe F. K., e datës 10.5.2013.

<sup>66</sup> Kontratë investimi nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 15.4.2005.

<sup>67</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.7.2020.

<sup>68</sup> Kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.8.2001.

<sup>69</sup> Nëpërmjet të cilit vërtetohet se në emër të z. A. Z. është e regjistruar pasuria me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* , e ndodhur në z. k. \*\*\* , me sipërfaqe trualli 1500 m<sup>2</sup>, me adresë: lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë.

<sup>70</sup> Kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.4.2005.

<sup>71</sup> Deklaratë noteriale për njohje dhe shlyerje detyrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.5.2013.

Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti ka argumentuar se vendimi i asamblesë së ortakëve është marrë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe statutore dhe për sa kohë asnjë nga ortakët nuk ka pasur dhe nuk ka pretendim për këtë vendim, ky i fundit ka krijuar efektet e tij ligjore prej momentit të miratimit. Si përfundim, subjekti ka theksuar se nuk ekziston dhe as rezulton asnjë veprim bankar apo në arkën e shoqërisë të kryer për shoqërinë nga bashkëshortja e tij ose anasjelltas, që të lidhet me shuma të dhëna hua/investuar shoqërisë/në shoqëri prej saj.

Lidhur me konstatimin e Komisionit për mungesën e dokumentacioni shoqëruar të vendimit të asamblesë të datës 24.5.2005, që ka të bëjë me thirrjen e ortakëve për mbledhjen e saj nëpërmjet shërbimit postar me letër rekomande, subjekti pretendoi se pas kërkesës së bërë shoqëria i ka bërë me dije se është në pamundësi të sigurojë një kopje të letrës rekomande për thirrjen e asamblesë së ortakëve, për sa kohë është tej çdo afati ligjor të përcaktuar për ruajtjen e dokumentacionit.

Nga vlerësimi tërësor dhe në harmoni i provave të administruara, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk vërtetohet, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e ortakës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., t’i ketë dhënë hua/investuar shoqërisë/në shoqëri shumë prej 19,437,815 lekësh në vitin 2005, në referim të përqindjes së koutave të zotëruara prej saj në kapitalin e shoqërisë.

Nuk u evidentua/dokumentua asnjë veprim financiar i znj. D. G. – i kryer prej saj në cilësinë ortakës së kësaj shoqërie – që të lidhet me këtë shumë (vlera prej 39,699,012 lekësh) të deklaruar në bilancin e shoqërisë si gjendje në datën 31.12.2005, në llogaritë vjetore (gjendje financiare) për vitin 2005 – në detyrime të kërkueshme pas më shumë se një viti (ortakë).

Për më tepër, rezulton se vetë ortaku tjetër ka pranuar se kjo shumë i është dhënë hua shoqërisë prej tij, duke e bazuar pretendimin në vendimin e asamblesë dhe dokumentacion tjetër provues të depozituar pas dërgimit të rezultateve të hetimit që lidhen me investimin e tij si individ në një kompleks banimi dhe shërbimi, për të cilin leja e ndërtimit është nxjerrë edhe në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Gjithashtu, nga verifikimi i bilancit të vitit 2006 – të dorëzuar nga kjo shoqëri në organin tatimor – konstatohet se llogaritë e ortakut në pasiv të bilancit janë zero, që do të thotë se detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut/ortakëve janë zeruar. Në këtë kuptim, personi i lidhur, sikurse deklaroi se nuk ka dhënë hua shoqërisë, po ashtu nuk ka pretenduar kthim të kësaj huaje dhe as se e ka deklaruar ndonjëherë këtë fakt.

↓ **Si përfundim, Komisioni çmon se në mungesë të provave bindëse që të lidhin bashkëshorten e subjektit me dhënien e kësaj huaje, si dhe në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, shuma prej 19,437,815 lekësh nuk do të përfshihet në analizën financiare të vitit 2005 si hua e dhënë nga ortaku (personi i lidhur) për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

Siç u evidentua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura të përfituara si fitues i lotarisë amerikane shumë prej 500,000 USD, nga të cilat shuma *neto* pas pagesës së tatimit është 335,000 USD. Për dokumentimin e këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar (Aneks 4/16 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentacion fotokopje, si vijon: (i) çek të datës 14.3.2005, lëshuar nga Thesari i Shtetit të Illinois, shuma e kredituar 500,000 USD, paguar taksa gjithsej 165,000 USD, shuma *neto* 335,000 USD, shoqëruar me deklaratë të ardhurash, në

gjuhën angleze; (ii) dokument bankar nga City Gold, datë 28.3.2005, për gjendjen në llogari në vlerën 335,000 USD, në gjuhën angleze; (iii) nxjerrje llogarie nga City Gold, datë 31.12.2016, për gjendjen në llogari në vlerën prej 223,141.45 USD, në gjuhën angleze; (iv) transfertë bankare datë 31.3.2005, nga llogaria e z. Artur Gaxha në City Bank, ku vërehet transferimi i shumës 85,000 USD me përfitues këtë shtetas në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në gjuhën angleze; (v) nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” për kreditimin në llogari në datën 1.4.2005, të shumës 84,866 USD; dhe (vi) vërtetim datë 13.1.2017, nga “Raiffeisen Bank” për llogarinë më vlerë 85,463.38 USD.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar konfirmohet se në datën 1.4.2005 në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” është transferuar shuma prej 84,866 USD – me burim të pretenduar të ardhurat e përfituara nga lotaria e fituar në SHBA.

Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, materialet shkresore që shoqërojnë deklaratën *Vetting*, duket se në datën 9.7.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz”, në shumën 4,500 euro. Në përfundim të procedurave të zhdoganimit të kryera, vlera e këtij automjeti përlllogaritet afro 958,071 lekë.

DPSHTRr-ja<sup>72</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\* (targa e mëparshme \*\*\*) dhe se nga verifikimi i dosjes konstatohet se ky automjet është blerë në vitin 2005 në shumën 4,500 euro (pa përfshirë shpenzimet e zhdoganimit) dhe është shitur në vitin 2011, në shumën 8,000 euro.

*Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2005.*

Në DPV-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar pasurinë autoveturë, tip “Mercedes Benz”, i patarguar, me vlerë 9,500 euro, krijuar në korrik të vitit 2004. Në vijim të verifikimit të DPV-ve vjetore duket se pas vitit 2005 subjekti ka deklaruar vetëm shitjen e një automjeti tip “Mercedes Benz”, identifikuar me targa \*\*\*, i shitur në vitin 2011.

Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e tij lidhur me konstatimin e mësipërm, si dhe të vërë në dispozicion dokumentacion justifikues ligjor për automjetin tip “Mercedes Benz”, të deklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2004, me vlerë 9,500 euro, subjekti i rivlerësimit, me dërgimin e prapësimeve, ndër të tjera, ka parashtruar se bëhet fjalë për të njëjtin automjet të deklaruar në DPV-në e vitit 2004 dhe të targuar në vitin 2005. Kjo autoveturë është blerë prej tij në korrik të vitit 2004 përkundrejt pagesës së çmimit të blerjes në total (duke përfshirë edhe shpenzimet e zhdoganimit) prej 9,500 euro. Ky automjet ka qenë i papajisur me dokumentacionin përkatës, fakt i cili ka bërë që ta deklarojë si të patarguar ende në DPV-në e vitit 2004. Ky automjet është regjistruar në DRSHTRr-në Tiranë vitin 2005, pasi në atë kohë është përpiluar edhe dokumentacioni ligjor për kalimin e pronësisë në emrin e tij.

Komisioni vëren se, në referim të dokumentacionit të administruar në dosje dhe të depozituar si provë nga vetë subjekti i rivlerësimit, provohet se ky automjet është blerë në Gjermani në vitin 2005 për shumën prej 4,500 euro dhe zhdoganimi i tij është bërë në datën 9.7.2005, duke u paguar në total vlera e detyrimit doganor në shumën 396,149 lekë. Nuk disponohen të dhëna të tjera për futjen e këtij automjeti më parë në territorin shqiptar.

<sup>72</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019.

- ↓ Për sa më sipër, në vlerësim të provave të administruara, si dhe në mungesë të të dhënave të besueshme për kryerjen e pagesës për blerjen e këtij automjeti nga subjekti në vitin 2004, Komisioni vlerësoi se shuma totale e evidentuar si e shpenzuar për këtë automjet nga subjekti i rivlerësimit (vlera e blerjes + detyrime doganore) do të përfshihen në analizën financiare të vitit 2005.

Pas kalimit të barrës së provës për rezultatin financiar të vitit 2005 – krahas sa u analizua më sipër – subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse për zëra të tjerë të analizës financiare të vitit 2005, në vlerësim të të cilave Komisioni vendosi që ndryshe nga analiza financiare paraprake e dërguar me rezultatet e hetimit në analizën përfundimtare: (i) të reduktohen shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit për udhëtime të dokumentuara si të kryera për shkak të detyrës, si dhe pasqyrimi i ndarë në dy vite i shpenzimeve të udhëtimit, për një udhëtim të kryer në vitet 2004 - 2005; (ii) bazuar në vetëdeklarimin e subjektit janë shtuar shpenzime të kryera për automjetin e markës “Suzuki”, tip “Vitar”.

- ❖ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimin e prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe verifikimin e kryer për burimet financiare të deklaruara për blerjen e pasurive, shtesat në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005, të pasqyruar, si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të dokumentuara	837,538
Të ardhurat e bashkëshortes, të dokumentuara	512,575
Të ardhura nga sigurimet, bashkëshortja, referuar “Raiffeisen Bank”	196,535
Kalim nga llogaria në SHBA	8,505,100
Të ardhura nga interesa	144,148
<b>Total te ardhura/të hyra financiare</b>	<b>10,195,896</b>
Shpenzime për telefoni celulare, referuar pagesave në “Raiffeisen Bank”	129,020
Paguar për zhdoganim + shpenzime të tjera (të deklaruara) për automjetin tip “Suzuki”	407,802
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi)	363,566
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	419,968
<b>Total shpenzime/ të dala financiare</b>	<b>1,320,356</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	-1.056.280
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>7,819,260</b>
Pagesë për blerje ap. Golem, vlera 26.000 euro, referuar kontratës së sipërmarrjes dhe DPV-së 2005 ( form. mbi detyrime financiare)	3,186,040
Pagesë për blerje apartament, zyrë dhe garazh, vlera 134,150 USD	13,423,049
Pagesë për blerje automjeti tip “Mercedes Benz”	958,071
<b>Total pasuri</b>	<b>17,567,160</b>

Detyrime	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	17,567,160
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>- 9,747,900</b>

↓ **Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2005.**

#### **Shitja e apartamentit, të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”**

Konstatohet se në datën 17.10.2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë hequr dorë nga e drejta<sup>73</sup> që i lindi nga kontrata e sipërmarrjes, datë 19.8.2005, për apartamentin me sip. 147 m<sup>2</sup>, ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe kalimin e të drejtave sipas kësaj kontrate në favor të shtetases V.B.

Në nenin 2 të kontratës me titull “vlefte dhe mënyra e pagesës” përcaktohet se vlefte e përgjithshme e apartamentit objekt kontrate është në shumën 120,000 euro, shumë e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

Konfirmohet se likuidimi i shumës prej 120,000 euro është kryer në datën 17.10.2011 me transfertë bankare nga llogaria e blerësit në llogarinë e znj. D. G., në “Raiffeisen Bank”.

Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa deklarata të tatimit mbi të ardhurat individuale (DIVA) për periudhën tatimore të vitit 2011, të cilat janë korrigjuar në periudha të ndryshme edhe pas deklarimit në deklaratën *Vetting*.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore për fitimet kapitale të ardhura nga shitja e apartamentit në blv. “\*\*\*\*”, duke bashkëlidhur si dokumentacion provues urdhërpagesa të kryera për shlyerjen e detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale për vitin 2011, ku janë të përfshira edhe të ardhurat shtesë të përfituara nga kalimi i të drejtave për pasurinë e llojit apartamenti, të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”.

Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të të ardhurave për vitin 2011 (dorëzuar më 28.9.2012) konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar fitime kapitale nga shitja e pasurive të paluajtshme, përkatësisht shumat 3,460,000 lekë secili, në total 6,920,000 lekë (shumë e cila nuk ka ndryshuar edhe pas deklarimit të korrigjimeve në datën 20.9.2017).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, bazuar në vetëdeklarimin e bërë në DIVA-t e vitit 2011, kanë paguar detyrimin tatimor për të ardhurat e përfituara nga fitimet kapitale prej shitjes së pasurisë të paluajtshme para dorëzimit të deklaratës *Vetting*, përkatësisht për shumat 3,460,000 lekë secili, në total për vlerën prej 6,920,000 lekësh.

Në referim të çmimit të shitjes së kësaj pasurie nga subjekti/personi i lidhur (shuma prej 120,000 euro, konvertuar në 16,869,600 lekë me kursin zyrtar të BSH-së të datës 17.10.2011, sipas të cilit 1 euro = 140.58 lekë), si dhe deklarimeve të tij për shumën e blerjes së këtij apartamenti në vlerën

<sup>73</sup> Kontrata për dorëzim apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.10.2011.

prej 70,000 USD (konvertuar me kursin zyrtar të BSH-së të datës 19.08.2005, 1 USD =100.06 lekë, në 7,004,200 lekë) duket se shuma e fitimeve kapitale nga kalimi i të drejtave për këtë pasuri është në vlerën 9,865,400 lekë (16,869,600 lekë - 7,004,200 lekë). Pra, u konstatua se për shumën 2,945,400 lekë (9,865,400 lekë - 6,920,000 lekë) nuk janë deklaruar dhe paguar detyrimet përkatëse tatimore.

Pasi iu kërkua të japë shpjegime lidhur me këtë fakt, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se vlerësimi dhe përlllogaritja e kryer nga Komisioni është e saktë. Për shkak të një gabimi në aplikimin e kursit të këmbimit (USD në vend të euro) është llogaritur gabim fitimi kapital i realizuar nga tjetërsimi i apartamentit të sipërcituar. Me marrjen dijeni rreth këtij gabimi të konstatuar nga Komisioni kanë paraqitur kërkesë pranë DRT-së Tiranë për të bërë korrigjimet përkatëse, me qëllim bërjen të mundur të pagesës së diferencës së konstatuar, pasi nuk ka pasur asnjë qëllim apo tendencë për të shmangur pagesën e detyrimeve tatimore. Pas korrigjimit të deklaratave nga DRT-ja Tiranë sipas kërkesës së bërë, u krye pagesa e diferencës së detyrimit tatimor të lindur.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues: (i) aktsistemimin e datës 31.10.2019, të përpiluar nga inspektorë të kontrollit në DRT-në Tiranë; (ii) 2 fletë njoftim vlerësimi<sup>74</sup> për detyrimet tatimore të datës 31.10.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij; si dhe (iii) 2 mandate bankare të datës 1.11.2019, për kryerjen e pagesave të detyrimit në “Raiffeisen Bank”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti konstatohet se, bazuar në kërkesën e bërë nga personi i lidhur, znj. D. G., për saktësimin e deklaratës individuale të të ardhurave të vitit 2011 në lidhje me vlerën e deklaruar në rubrikën [7] “Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit”, është bërë aktsistemimi i datës 31.10.2019 – për sa i përket fitimit të realizuar në vitin 2011 nga shitja e apartamentit, sipas kontratës nr. 3366 rep., nr. 2723 kol., datë 17.10.2011, me objekt: “heqja dorë nga Artur Gaxha dhe D. G. dhe dorëzimi në favor të V. B., nga e drejta që lind nga kontrata e sipërmarrjes nr. 6901 rep., nr., datë 19.8.2005, për apartamentin në adresën: Blv. ‘\*\*\*’, me sip. 147 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\*, nr. \*\*\*, kulla \*\*\*.”

Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, vlera e apartamentit në blerje është 70,000 USD, konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, në vlerën prej 7,004,200 lekësh. Ndërkohë, referuar kontratës për kalimin e të drejtave mbi këtë pasuri – vlera në shitje e këtij apartamenti është 16,869,600 lekë. Si rrjedhim, fitimi kapitali i realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja– nëpërmjet kalimit të të drejtave mbi këtë pasuri – është në vlerën prej 9,865,400 lekësh (vlera në shitje 16,869,600 lekë – vlera në blerje 7,004,200 lekë). Nga kjo, vlera e fitimit për pjesën përkatëse ½ për secilin (subjektin dhe bashkëshorten) rezulton: (i) z. Artur Gaxha  $9,865,400 \text{ lekë} / 2 = 4,932,700 \text{ lekë}$ ; dhe (ii) znj. D. G.  $9,865,400 \text{ lekë} / 2 = 4,932,700 \text{ lekë}$ .

Për sa më sipër, individi deklarues, znj. D. G., ka kërkuar saktësimin e rubrikës [7] “Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit”, të deklaruar në DIVA-n

---

<sup>74</sup> Njoftim vlerësimet për detyrimet tatimore nxjerrë nga DRT-ja Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2013, dhe nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2019.



e vitit 2011, ku sipas shpjegimit të bërë në kërkesë vlera e deklaruar në këtë rubrikë në shumën prej 3,460,000 lekësh është e pasaktë si efekt i aplikimit të gabuar të kursit të këmbimit.

Bazuar në kërkesën e sipërcituar dhe në referim të dokumentacionit të dorëzuar, inspektori i kontrollit në DRT-në Tiranë ka bërë sistemin e deklaratës DIVA të vitit 2011, që i përket subjektit të rivlerësimi dhe bashkëshortes së tij, me të dhënat si vijon:

<b>Rubrika</b>	<b>Ishte</b>	<b>Bëhet</b>	<b>Diferenca</b>
[7] Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme	3,460,000	4,932,700	1,472,700
[20] Të ardhurat e tatueshme	6,532,025	8,004,725	1,472,700
[22] Shuma e tatimit të llogaritur	653,202	800,473	147,271

Pas këtij rivlerësimi diferenca e tatimit të paguar rezulton në shumën 147,271 lekë, më tepër se deklarata e dorëzuar nga subjekti dhe bashkëshortja, veçmas.

Referuar këtij aktsistemi, pasi janë llogaritur edhe gjobat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka nxjerrë dy aktet administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore, njëri drejtuar subjektit të rivlerësimi dhe tjetri bashkëshortes së tij, ku detyrimi total për t'u paguar nga secili është në shumën 179,523 lekë (nga të cilat tatimi 147,271 lekë dhe gjoba 32,252 lekë).

Konstatohet se në datën 1.11.2019, subjekti i rivlerësimi dhe bashkëshortja kanë paguar detyrimin tatimor që ka lindur nga aktsistemi i mësipërm në shumën prej 256,417 lekësh secili, e cila duket se përfaqëson tatimin dhe gjobën e pasqyruar në njoftim vlerësimi, si dhe interesat e gjeneruara nga sistemi tatimor për deklarim dhe pagesë të vonuar të këtij detyrimi.

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimi kërkoi që shuma e përfituar nga shitja e apartamentit të konsiderohet e plotë si e ardhur e ligjshme, pasi vullneti i tij për të paguar detyrimet tatimore vërtetohet nga vetëdeklarimet që në momentin e përfitimit të të ardhurave, si dhe duhet të vlerësohet gatishmëria e tij për të paguar edhe diferencën e konstatuar me të drejtë nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se mospagimi i diferencës së tatimit nuk ka qenë i qëllimshëm, por ka ardhur si pasojë e një gabimi në llogaritje (gabimi material), duke konsideruar vlerën e blerjes gabimisht në euro, ndërkohë që çmimi i paguar për apartamentin ka qenë në monedhën dollarë.

➤ Në vlerësim përfundimtar të dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me këtë çështje, Komisioni konstaton se:

i) subjekti dhe bashkëshortja kanë vetëdeklaruar në deklaratën individuale të të ardhurave të vitit 2011 fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme/kalimi i të drejtave mbi pasurinë e llojit apartament. Në këtë kuptim, Komisioni çmon se del qartë vullneti i tyre për deklarimin e të ardhurave të përfituara nga ky transaksion dhe pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse;

ii) çmimi i blerjes së kësaj pasurie, apartamentit (për të cilat u kaluan të drejtat) është vetëdeklaruar nga subjekti, pasi në referim të kontratës së sipërmarrjes nuk ishte evidentuar çmimi i apartamentit, por ishte përcaktuar një çmim total në vlerën prej 134,150 USD për blerjen e 3 pasurive, apartament + njësi + garazh. Në këtë këndvështrim, nëse do të supozohej se qëllimi i subjektit ka qenë shmangia e pagesës së detyrimeve tatimore, ai ka pasur mundësinë që të vetëdeklaronte çmim më të lartë të blerjes së apartamentit – çka do të sillte diferencë më të vogël

të të ardhurave të përfituara nga fitimi kapital i shitjes/kalimit të të drejtave të pasurisë së paluajtshme dhe, rrjedhimisht, pagesë në vlerë më të vogël të tatimit përkatës;

iii) në shpjegimet e tij subjekti ka pretenduar se pasaktësia në llogaritjen e fitimit kapital *neto* nga shitja e pasurisë së paluajtshme/kalimi i të drejtave nuk ka qenë e qëllimshme, por ka ardhur si pasojë e një gabimi material, aplikimit të gabuar të kursit të këmbimit;

iv) subjekti ka pranuar pasaktësinë e evidentuar nga Komisioni dhe ka shprehur gatishmërinë për korigjimin e kësaj situatë – ka bërë kërkesë zyrtare pranë organit publik (DRT-ja Tiranë) dhe ka paguar diferencën e tatimit së bashku me gjobat dhe interesat e llogaritura (për deklarim dhe pagesë të vonuar) si pasojë e sistemimit të deklaratave individuale të të ardhurave të vitit 2011.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se duken bindëse dhe në harmoni me provat e administruara shpjegimet e subjektit lidhur me mosdeklarimin dhe pagimin në kohë të diferencës së tatimit për kalimin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme. Në kushtet kur është i provuar vullneti i subjektit për deklarimin në kohë të këtij transaksioni para organeve publike, pasaktësia në deklarimin e vlerës në vlerësim të shpjegimeve të subjektit duket të jetë e paqëllimshme dhe si pasojë e një gabimi material. Si rrjedhim, Komisioni arrin në përfundimin se në analizën financiare do të pasqyrohet/reflektohet e plotë shuma e përfituar nga shitja/kalimi i të drejtave mbi pasurinë e llojit apartament.

**31. Pasuria e llojit auoveturë, tip “Mercedes Benz”<sup>75</sup>, me targa \*\*\*, me vlerë 55,000 USD, në bashkëpronësi me të afërmen e tij, znj. A. G. Pjesa takuese: ½. Vlera: 27,500 USD. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka referuar të ardhurat e deklaruara në seksionin “të dhëna konfidenciale”.**

Referuar DPV-së për vitin 2011, subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë auoveturë, tip “Mercedes Benz”, në bashkëpronësi me të afërmen e tij, znj. A. G., në vlerë 55,000 USD, me pjesë takuese 50 %. Por, konstatohet se në DPV-në e vitit 2011 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Ndërkohë, nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* (shtojca 2), në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, duket se subjekti i rivlerësimit ka referuar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat të përfituara nga lotaria amerikane në vitin 2005.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

DPSHTRr-ja<sup>76</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, ka në pronësi automjetin me targa \*\*\*– duke dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti.

Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRr-ja konstatohet se: (i) ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar në vitin 2011 (përshkrimi në certifikatën e titullit: automjeti në pronësi të z. Artur Gaxha dhe znj. A. G. për eksport, prill 2011, Porti i New York-ut); (ii) referuar dokumentit certifikatë regjistrimi për automjete të Ëinsconsin SHBA, ky mjet është në pronësi të shtetasve Artur Gaxha dhe A. G. – për të cilin është bërë pagesa prej 78 USD dhe se kjo certifikatë skadon në datën 28.2.2014; (iii) në datën 28.5.2014 është kryer zhdoganimi i këtij automjeti dhe vlera e blerjes deklaruar në doganë ka qenë 350,000 lekë – ndërsa nga Dega Doganore e Tiranës është aplikuar një çmim prej 18,392 USD, duke u paguar detyrime doganore në vlerën 403,249 lekë

<sup>75</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së): (1) certifikatë pronësie e automjetit nr. \*\*\*, datë 5.6.2014 + certifikatë titulli + certifikatë regjistrimi, informacion imbarikimi dhe certifikatë titulli, në gjuhën angleze.

<sup>76</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019, dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019.

dhe përfshirë shpenzimet e targimit, në vlerën totale prej 497,653 lekësh (deklaruar DPV-në e vitit 2014; dhe (iv) referuar certifikatës së pronësisë, automjeti tip “Mercedes Benz ML550” është regjistruar në DPSHTRr-në Tiranë në datën 5.6.2014.

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me zhdoganimin/regjistrimin e këtij automjeti pas afro tri vitesh nga hyrja e tij në territorin shqiptar dhe se përse vlera në doganë nuk është deklaruar në shumën 45,666 USD (në referim të faturës së blerjes), ndër të tjera, deklaroi se<sup>77</sup> përgjatë kësaj periudhe është përdorur në Shqipëri me targat amerikane, kjo edhe për faktin që bashkëpronarja ishte shtetase amerikane dhe se prej tyre (bashkëpronarëve) janë paguar të gjitha detyrimet për përdorimin e automjetit brenda dhe jashtë territorit shqiptar. Lidhur me praktikën e zhdoganimit të automjetit sqaron se, ashtu siç është edhe procedura ligjore e parashikuar në ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999, i ndryshuar (Kodi Doganor), neni 17 dhe VKM nr. 205, datë 17.4.1999, është kryer nga një agjenci doganore e licencuar për këtë qëllim. Agjencisë doganore i është vënë në dispozicion gjithë dokumentacioni i automjetit, të cilin dispononte dhe është pjesë e dosjes së automjetit. Pas plotësimit të dokumentacionit prej agjencisë doganore dhe përcaktimit të detyrimit për t’u likuiduar, është kryer edhe pagesa e llogaritur prej tyre. Nga ana e tij nuk është bërë asnjë deklaram në lidhje me vlerën e blerjes së automjetit, për sa kohë gjithë kjo praktikë e zhdoganimit është përgatitur dhe finalizuar nga agjencia.

### **Lidhur me pagesën e kryer nga subjekti për këtë pasuri**

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, në bashkëpronësi me të afërmen, znj. A. G., pagesa për shlyerjen e shumës përkatëse është kryer në llogari të shitësit të automjetit në shumën 45,666 USD, nga llogaria e tij pranë City Bank. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga lotaria e fituar.

Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, duket se, në datën 15.2.2011 vlera prej 45,666.08 USD është transferuar nga City Gold *account* \*\*\* në emër të subjektit të rivlerësimit, në llogari të Motor Werks of Barrington.

Subjekti, i pyetur lidhur me kohën, vlerën dhe mënyrën e shlyerjes së shumës prej 27,500 USD nga bashkëpronarja e këtij automjeti (në konsideratë të vetëdeklarimit të bërë nga subjekti), në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaron se shuma rreth 4,500 USD është paguar nga bashkëpronarja në SHBA për të kryer pagesën e faturave të ndryshme (referuar në vijim të përgjigjeve të këtij pyetësori) – shuma prej 15,000 USD është paguar *cash* gjatë dy vizitave të saj në Shqipëri në vitin 2011 (muajt mars dhe korrik) dhe diferenca prej 8,000 USD është paguar *cash* gjatë vizitës së saj në Shqipëri në vitin 2013.

- ✓ Konstatohet se për periudhën 2011 – 2013 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-të e dorëzuara në ILDKPKI “hua”<sup>78</sup> të dhënë në favor të së afërmes së tij, znj. A. G., apo kthimin e shumave të pretenduara si detyrime të cilat ajo kishte për t’i shlyer subjektit për të mbuluar pagesën e automjetit në bashkëpronësi me të.

<sup>77</sup> Referohuni pyetësorit nr. 4.

<sup>78</sup> Në vlerësim të faktit se subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë për këtë automjet, por ndërkohë rezultoi se pagesa për blerjen e tij është kryer nga llogaria e subjektit, Komisioni në një lloj mënyre e ka konsideruar si hua shumën që ka pasur detyrim të paguajë e afërmi e subjektit për shkak të bashkëpronësisë – shumë të cilën nuk e ka paguar në momentin e blerjes së këtij automjeti.

Referuar informacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 9.3.2011 nga llogaria nr. \*\*\*, në USD, në emër të bashkëshortes së subjektit, është transferuar shuma prej 5,000 USD, me përfitues shtetasin L. G..

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me arsyen e transferimit të kësaj vlere monetare, deklaroi se<sup>79</sup> shuma prej 5,000 USD është transferuar në llogarinë e të afërmit të tij, z. L. G. (vëllai i znj. A. G.) në funksion të pagesave që po kryheshin për mbulimin e shpenzimeve të tjera pas blerjes së automjetit në bashkëpronësi të tij dhe motrës së përfituesit të transfertës. Këto fonde do të përdreshin për pagesën e shpenzimeve të transportit të siguracionit të automjetit, ose ndonjë shpenzim tjetër.

Në vlerësim të këtyre të dhënave, për sa kohë nuk u provua pagesa e ½ pjesë të çmimit të çmimit të blerjes + shpenzimet e tjera nga bashkëpronarja tjetër e këtij automjeti, znj. A. G., Komisioni, në rezultatet paraprake të hetimit, ngriti dyshime të arsyeshme se automjeti i sipërcituar është blerë dhe përdorur ekskluzivisht nga subjekti i rivlerësimit, duke hedhur dyshime se bashkëpronësia e këtij automjeti është kryer me qëllim pjesëtimin e kostos së tij.

Me dërgimin e prapësimeve përfundimtare, por edhe gjatë shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se gjithë dokumentacioni ligjor mbi pronësinë e automjetit provon që ky automjet ka qenë dhe është në bashkëpronësi të tij dhe me të afërmen, znj. A. G..

Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se bashkëpronarja e këtij automjeti në periudhën e blerjes së tij vizitonte shumë shpesh Shqipërinë dhe ishte përdoruesja kryesore e automjetit gjatë këtyre vizitave. Madje edhe familjarët e saj, për periudha të ndryshme kohore, kanë përdorur automjetin gjatë vizitave të tyre në Shqipëri.

Për të provuar pretendimet e tij, për çka ka deklaruar në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë hetimit administrativ, si dhe në prapësimet e depozituara pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar si provë të re deklaratën e shtetases A. G..

Komisioni vëren se nga njëra anë pretendohet se znj. A. G. ka pasur detyrime ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak të blerjes së këtij automjeti, nga ana tjetër, në datën 9.3.2011 nga llogaria e bashkëshortes së tij është transferuar në llogari të vëllait të znj. A. G. shuma prej 5,000 USD.

Nga vëzhgimi i kryer në sistemin *TIMS* duket se znj. A. G. ka hyrë në territorin shqiptar në datën 4.3.2011. Në këtë këndvështrim, duket kontradiktor deklarimi i subjektit se e afërmja e tij gjatë kësaj vizite i ka dorëzuar në *cash* një pjesë të vlerës për blerjen e automjetit dhe në të njëjtën kohë, në datën 9.3.2011 subjekti/personi i lidhur kryen transfertë që shërben në funksion të blerjes së automjetit/transportit të tij apo kryerjen e shpenzimeve të tjera.

Nga verifikimi i dosjes së automjetit nuk evidentohet momenti i hyrjes së tij në territorin shqiptar, por në kushtet kur sipas certifikatës së titullit është dërguar për eksport në prill të vitit 2011, si dhe në referim të të dhënave të vëzhguara nga sistemi *TIMS*, praktikisht duket se bashkëpronarja tjetër ka pasur mundësinë fizike ta përdorë këtë automjet vetëm dy herë gjatë vizitave të saj në Shqipëri, çka duket se nuk është në proporcion dhe nuk justifikon në mënyrë logjike pagesën e pretenduar prej ½ të çmimit për blerjen e tij, si të kryer prej saj.

---

<sup>79</sup> Pyetja/përgjigjja nr. 2, e pyetësorit nr. 4.

↓ **Në analizë përfundimtare të dokumentacionit të administruar lidhur me këtë pasuri, si dhe shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se:**

i) subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri në bashkëpronësi, në referim të certifikatës së titullit dhe regjistrimit të këtij automjeti në DPSHTRr-në Tiranë;

ii) nuk dokumentohet pagesa e ndonjë vlere monetare nga bashkëpronarja tjetër e automjetit – në këtë kuptim duket se qenia bashkëpronare në këtë pasuri ka ardhur si pasojë e vullnetit të subjektit të rivlerësimit, identifikuar si personi që ka kryer pagesën e plotë për blerjen dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit të automjetit deri në shtetin shqiptar.

Trupi gjykues çmon se z. Artur Gaxha nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për dokumentimin e pagesës së pjesës prej ½ të çmimit të blerjes së kësaj pasurie nga e afërmja e tij, znj. A. G..

Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se në analizën financiare përfundimtare do të reflektohet vlera e plotë e dokumentuar e shpenzuar për blerjen e këtij automjeti<sup>80</sup>, si e paguar nga subjekti i rivlerësimit. Si rrjedhim, në analizën financiare të viteve 2011 dhe 2013 nuk do të pasqyrohen si të ardhura vlerat e pretenduara të sjella *cash* nga e afërmja e tij, znj. A. G., në këto vite.

Në referim të dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se pagesa prej 45,666 USD e kryer për këtë automjet është bërë nëpërmjet transfertës bankare nga fondet e subjektit në llogarinë bankare në emrin e tij në SHBA – me burim të ardhurat e përfituara nga fitimi i lotarisë. Si pagesë tjetër e kryer për këtë automjet gjatë vitit 2011 është evidentuar (edhe nga vetëdeklarimi i subjektit) transfera e shumës prej 5,000 USD nga llogaria bankare e bashkëshortes së subjektit tek z. L. G..

### **Të ardhurat nga qiradhëniet**

Nga verifikimi i deklaratave periodike të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI konstatohet se subjekti i rivlerësimit për vitet 2011, 2013, 2014 dhe 2015 ka deklaruar të ardhura të përfituara nga dhënia me qira e ambienteve në pronësi/në zotërim të tij dhe personit të lidhur, konkretisht me të dhënat e vetëdeklaruar si:

- Referuar DPV-së së vitit 2011 ka deklaruar: (i) të ardhura të përfituara nga qiradhënia e apartamentit të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, për periudhën mars – tetor 2011, me qira mujore në vlerën 500 euro, në total shuma 4,000 euro; dhe (ii) të ardhura nga qiradhënia e zyrës (dyqanit) me sip. 40 m<sup>2</sup>, të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, për periudhën prill – dhjetor 2011, me qira mujore në vlerën 30,000 lekë, në total shuma 270,000 lekë.
- Referuar DPV-së për vitin 2013 ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja e dyqanit në pronësi – për 7 muaj, në shumën 270,000 lekë; dhe (ii) të ardhura nga qiraja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, për 7 muaj, në shumën 2,847 USD.
- Referuar DPV-së për vitin 2014 ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja e ambientit zyrtë për një periudhë 11 muaj, në shumën 330,000 lekë; dhe (ii) të ardhura nga qiraja e apartamentit të banimit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, në shumën 8,000 euro.

<sup>80</sup> Vlera prej 45,666 USD, evidentuar si transfertë e kryer nga llogaria e tij në SHBA, si dhe shuma prej 5,000 USD evidentuar si shumë e transferuar në llogarinë e vëllait të bashkëpronares së automjetit – deklaruar nga subjekti për shpenzime të automjetit.

- Referuar DPV-së për vitin ka deklaruar: të ardhura nga qiraja e ambientit zyrë në pronësi të tij dhe bashkëshortes për 12 muaj, në shumën 360,000 lekë.

Për të dokumentuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues në ILDKPKI (pjesë e dokumentacionit të depozituar prej tij me dorëzimin e deklaratës “Vetting” kontratat, si vijon: (i) kontratë qiraje datë 21.3.2011 – për dhënien me qira të apartamentit të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) kontratë qiraje datë 20.4.2011 – për dhënien me qira të njësisë së shërbimit (dyqan) të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë; (iii) kontratë qiraje<sup>81</sup> datë 1.1.2013 – për dhënien me qira të apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (iv) kontratë qiraje datë 1.1.2014 – për dhënien me qira të apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (v) kontratë qiraje datë 1.2.2014 – për dhënien me qira të njësisë së shërbimit (dyqan) të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë; si dhe (vi) kontratë qiraje datë 1.2.2015 – për dhënien me qira të njësisë së shërbimit (dyqan) të ndodhur në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Referuara të dhënave të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>82</sup> konstatohet se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë deklaruar në deklaratat individuale të të ardhurave (DIVA) të ardhura nga qiraja. Por, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje Komisioni ka konstatuar se një pjesë e detyrimeve tatimore për këto të ardhura janë paguar pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” – bazuar edhe në rivlerësime të kryer nga administrata tatimore për këto deklarime. Të dhënat përmbledhëse për të ardhurat e deklaruara nga qiraja, detyrimin e paguar para deklaratës “Vetting”, si dhe detyrimin e tatimit të paguar pas rivlerësimit (datë 22.9.2017), pas deklaratës “Vetting”, paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

Viti	Të ardhura totale nga qiraja, DIVA, vers. 0 (lekë)	Detyrim tatim i llogaritur (lekë)	Detyrim tatimi i paguar përpara deklaratës <i>Vetting</i> (lekë)	Detyrim tatimi, pas rivlerësimit dhe pagesave -paguar pas deklaratës <i>Vetting</i> (lekë)
2011	825,720	82,572	63,829	18,743
2012	0	0	0	0
2013	253,670	25,367	1,692	23,675
2014	1,451,120	145,112	110,138	34,974
2015	180,000	27,000	27,000	0
2016	0	0	0	0
<b>Totale</b>	<b>2,710,510</b>	<b>280,051</b>	<b>202,659</b>	<b>77,392</b>

➤ Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ të kryer, si dhe shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti gjatë këtij procesi, rezulton se subjekti:

- ka deklaruar të ardhura nga qiraja në DPV-të e viteve 2011, 2013, 2014 dhe 2015;
- ka vetëdeklaruar në kohë në organin tatimor nëpërmjet DIVA-s të ardhurat e përfituara nga qiraja;

<sup>81</sup> Konfirmuar me dokumentin notarial vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 27.3.2013.

<sup>82</sup> Referojuni dy shkresave kthim-përgjigje të DRT-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2017), si dhe shkresës së dërguar në Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019.

- c) ka paguar pjesën më të madhe të detyrimeve të lidhura me të ardhurat e përfituara nga qiraja, para dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se subjekti/personi i lidhur, duke deklaruar këto të ardhura të përfituara në organin tatimor nëpërmjet deklaratave individuale të të ardhurave – krahas deklaramit në DPV-të vjetore të depozituara në ILKDKPKI – ka treguar vullnet të plotë për deklaramin dhe pagesën e detyrimit tatimor mbi të ardhurat e përfituara. Fakti i pagesës së një pjese të detyrimeve mbi këto të ardhura pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* duhet parë në logjikën e ndreqjeve të gabimeve të kryera në deklaram dhe, si rrjedhim, rivlerësimit të kryer nga organi tatimor për këto deklarata – në kushtet kur subjekti/personi i lidhur kanë pasur edhe të ardhura të tjera të përfituara në këto vite të deklaruara në DIVA-t përkatëse.

Si konkluzion, Komisioni vlerësoi se për vitet përkatëse (2011, 2013, 2014 dhe 2015) do të pasqyrohen të ardhurat e plota të përfituara nga qiraja, vlerat e të cilave janë deklaruar nga subjekti/personi i lidhur në deklaratat individuale të të ardhurave të depozituara në organin tatimor.

Në këtë rast, për vitin 2011 në analizën financiare do të pasqyrohet vlera e plotë e përfitur – deklaruar në DIVA si e ardhur nga qiraja në shumën 825,720 lekë.

Gjithashtu, krahas të ardhurave të evidentuara/dokumentuara, shpenzimeve të evidentuara/deklaruara, blerjes së automjetit dhe pagesës së kryer në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për apartamentin e ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, Komisioni konstatoi gjatë vitit 2011 se subjekti ka shtuar pasurinë, duke rritur gjendjen e likuiditeteve në bankë.

- ❖ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimit të prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe verifikimin e kryer për burimet financiare të deklaruara për blerjen e pasurive, shtesat në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera – Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, të pasqyruar në tabelën si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhura, subjekti i rivlerësimit nga paga, periudha	1042,878
Të ardhura, bashkëshortja nga paga, periudha	2,221,712
Të ardhura nga qiraja	825,720
Të ardhura nga shitja e apartamentit Blv. “****”, viti 2011	16,869,600
Të ardhura nga shitja e autoveturës “Mercedes Benz E300”, viti 2011	958,071
Të ardhura nga interesa/sistemim, kurset e këmbimit	240,423
Kalim nga llogaria SHBA (45,666 USD)	4,704,976
Kredi nga “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja, viti 2011	16,671,600
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>43,534,980</b>
Shpenzime për telefoni celulare “Credins Bank”	92,517
Shpenzime për kredi “Raiffeisen Bank”	899,784

Shlyer hua motrës, referuar DPV-së së vitit 2011	1,560,000
Shlyer detyrim për shoqërinë “***”, sh.p.k., shuma 120,000 euro	16,671,600
Shpenzime për shkollim, trajnime, eksp. profesionale	777,313
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi) <sup>83</sup>	1,016,574
Shpenzime tatime dhe taksa dhe rivlerësim/hipotekim pasurish të paluajtshme	241,605
Shpenzime mobilimi/arredimi etj., deklaruar	972,510
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	546,480
<b>Total shpenzime/ të dala financiare</b>	<b>22,778,384</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim-gj. fund periudhe deklaruar	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim-gj. fund periudhe dokumentuar	-17,275,631
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>3,480,965</b>
Blerje autoveture “Mercedes Benz ML550” (shumë e transferuar + shpenzim pas blerjes)	5,220,118
<b>Total pasuri</b>	<b>5,220,118</b>
Detyrime	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>5,220,118</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-1,739,153</b>

↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2011.

**32. Fond pensioni në “Raiffeisen Invest”, në emër të subjektit të rivlerësimit<sup>84</sup>**, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 196,123.37 lekë, krijuar me të ardhurat nga pagat.

**33. Tri llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”<sup>85</sup>**, me gjendje në datën 26.1.2017, si vijon: (i) llogaria në lekë në shumën 6,237.70 lekë; (ii) llogaria në valutë në shumën 70.07 euro; dhe (iii) llogaria në valutë në shumën 156.54 USD.

**34. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”<sup>86</sup>**, me gjendje në datën 25.1.2017, në shumën 14,235 lekë.

<sup>83</sup> Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit janë reduktuar shpenzimet e qëndrimit gjatë udhëtimit, për udhëtimin e kryer nga data 30.12.2010 – 2.1.2011, deklaruar qëndrimi tek vëllai i bashkëshortes në Greqi.

<sup>84</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së): - vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>85</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/8, 4/9 dhe 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së) - nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, për gjendjen e këtyre llogarive në datën 27.1.2017.

<sup>86</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin, vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, lëshuar nga “Credins Bank”.



**35. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>87</sup>**, në emër të vajzës së subjektit, me gjendje në datën 25.1.2017, në shumën 4,794.74 euro. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat familjare dhe të të afërmeve për ditëlindje dhe festa, ndër vite.

↓ Komisioni vëren se nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga bankat në kuadër të hetimit administrativ të kryer konfirmohen gjendjet e këtyre llogarive në momentin e deklarimit (të renditura në pikat 34 - 37 të këtij vendimi).

➤ **Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. D. G.**

**36. Obligacion me afat maturimi 2-vjeçar<sup>88</sup>** (datë 20.8.2015 - 20.8.2017) nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, me balancë në datën 25.1.2017, në shumën 150,000 euro. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*” Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 23.7.2013.

Referuar të dhënave nga “Intesa SanPaolo Bank”<sup>89</sup> rezulton se shuma 150,000 euro është pjesë e shumës prej 300,000 euro të depozituar *cash* në llogarinë nr. \*\*\* në euro, në emër të bashkëshortes së subjektit në këtë bankë (tërhequr *cash* në të njëjtën datë, 13.3.2014, nga llogaria e saj në “Raiffeisen Bank”), shumë kjo e përfutuar nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në vitin 2013.

**37. Obligacion me afat maturimi 2-vjeçar<sup>90</sup>** (datë 2.12.2016 - 2.12.2018) nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 100,000 euro. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 23.7.2013.

Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>91</sup> rezulton se shuma prej 100,000 euro, në datën 2.12.2016 është investuar në obligacion nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Në datën 29.8.2016 janë transferuar në këtë llogari nga llogaritë e subjektit dhe djalit të tij, përkatësisht vlerat 50,486.25 euro dhe 50,485 euro, të cilat kanë qenë të investuara në bono thesari me afat maturimi 12 mujor – shuma këto të përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në vitin 2013.

**38. Gjendje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>92</sup>**, me gjendje në datën 25.1.2017, në shumën 57,637.32 euro. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*\*” Tiranë, në vitin 2013.

---

<sup>87</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin, nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017.

<sup>88</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/25 në dosjen e ILDKPKI-ë) dokumentin, nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017, për gjendje bono thesari të znj. D. Gaxha, në vlerën 150,000 euro.

<sup>89</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>90</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/25 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin, nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017, për gjendje bono thesari të znj. D. Gaxha, në vlerën 100,000 euro.

<sup>91</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>92</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/25 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017.

**39. Gjendje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>93</sup>**, me gjendje në datën 25.1.2017, në shumën 6,155.52 euro. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “\*\*\*” Tiranë, në vitin 2013.

**40. Obligacion me afat maturimi 7-vjeçar<sup>94</sup>**, nëpërmjet “Raiffeisen Bank” (datë 16.9.2015 - 16.9.2022), me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 2,117,434.51 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga pagat dhe interesat e përfituara.

**41. Obligacion me afat maturimi 2-vjeçar<sup>95</sup>**, nëpërmjet “Raiffeisen Bank” (datë 23.9.2015 - 23.9.2017), me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 1,900,000 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe të ardhurat nga interesat bankar.

**42. Fond pensioni<sup>96</sup>** në “Raiffeisen Invest”, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 646,012.04 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar: (i) shumën 142,000 lekë si kontribut nga punëdhënësi; (ii) shumën 378,133.5 lekë; dhe (iii) shumën 125,878.44 lekë si interesa të llogaritura.

**43. Dy llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”<sup>97</sup>**, me gjendje në datën 26.1.2017 si vijon: (i) llogari në lekë në shumën 193,902 lekë; dhe (ii) llogari në valutë në shumën 7.59 euro.

↓ Komisioni vëren se nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga bankat në kuadër të hetimit administrativ të kryer, konfirmohen gjendjet e këtyre llogarive në momentin e deklarimit (të renditura në pikat 38 - 45 të këtij vendimi).

➤ **Pasuri të deklaruara veçmas nga djali i subjektit të rivlerësimit, K. G.**

**44. Llogari bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>98</sup>**, me gjendje në datën 25.1.2017, në shumën 3,862.4 euro, me burim dhurata në vite nga familjarët për festa, ditëlindje, etj.

**45. Depozitë cash - kolateral në “Raiffeisen Bank”<sup>99</sup>**, për të mbuluar limitin e kartës së kreditit, me balancë në datën 26.1.2017, në shumën 550 euro – llogari e financuar nga prindërit.

**46. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”<sup>100</sup>**, me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 550.36 lekë

↓ Komisioni vëren se nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga bankat në kuadër të hetimit administrativ të kryer, konfirmohen gjendjet e këtyre llogarive në momentin e deklarimit (të renditura në pikat 46 - 48 të këtij vendimi).

---

<sup>93</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/25 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017.

<sup>94</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/18 në dosjen e ILDKPKI-së) vërtetim për blerje obligacione thesari, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 15.10.2015.

<sup>95</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/19 në dosjen e ILDKPKI-së) vërtetim mbi shpalljen fituese të klientes D. Gaxha, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 15.10.2015.

<sup>96</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/20 në dosjen e ILDKPKI-së) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017, lëshuar nga “Raiffeisen Invest”.

<sup>97</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/21 dhe 4/22 në dosjen e ILDKPKI-së) nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, për gjendjen e këtyre llogarive në datën 26.1.2017.

<sup>98</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/26 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.1.2017.

<sup>99</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/26 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 25.1.2017.

<sup>100</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks 4/26 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 27.1.2017.

Analiza financiare për mundësinë e krijimit të llogarive bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur (bashkëshortes dhe fëmijëve të tij) – në formë llogarish rrjedhëse/depozitash/investimesh etj., apo shtesave të gjendjeve të tyre ndër vite – është kryer së bashku me analizimin e pasurive të tjera. Komisioni ka verifikuar të gjitha të ardhurat/burimet financiare, ligjshmërinë e tyre të deklaruara nga subjekti ndër vite, të cilat janë deklaruar si burim krijimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

## **47. ANALIZA FINANCIARE/ GJETJE TË TJERA NË DPV**

### **47.1 Automjet i markës “Toyota”, tip “Rav 4”**

Referuar DPV-së për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit autoveturë, të markës “Toyota”, tip “Rav 4” (pa vlerë të deklaruar), pronë e së motrës, znj. L. G. (shtetase amerikane), sipas vetëdeklarimit, targuar në emër të tij për efekt dokumentacioni.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

DPSHTRr-ja<sup>101</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\* (Toyota Rav 4), duke dërguar dosjen e plotë të tij. Rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka shitur<sup>102</sup> automjetin në datën 23.6.2016, për shumën 5,000 euro.

Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRr-ja, konstatohet: (i) referuar dokumentit certifikatë titulli, lëshuar në datën 17.3.2008, ky automjet është blerë në SHBA nga shtetasi L. H. në datën 29.2.2008, dhe në datën 17.3.2008 është bërë transferimi/shitja nga ky shtetas te subjekti i rivlerësimit; (ii) në datën 16.4.2008 ky automjet ka dalë për eksport jashtë territorit të SHBA-së dhe në datën 15.6.2008 ka hyrë në territorin shqiptar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit (me targa \*\*\*), verifikuar nëpërmjet sistemit *TIMS*.

Por, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2008 dhe as në DPV-të e viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

Referuar të dhënave të dërguara nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 27.2.2008, nga llogaria nr. 8002017429, në dollarë, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma prej 13,488.69 USD, me përfitues shtetasin L. H.

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni për arsyen e transferimit të këtyre vlerave monetare, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaroi se shuma 13,500 USD është transferuar në llogarinë e kumatit të tij të ndjerë (L. H.). Fondet ishin në pronësi të familjes së tij, pasi gjatë një prej vizitave familjare që kishin kryer më herët në Shqipëri kishin planifikuar një investim në *real estate*. Pas disa kohësh, planet dhe prioritetet e tyre ndryshuan dhe nuk vijuan me pagesën e kësteve të radhës, siç ishte parashikuar në kontratë dhe i kërkuan sipërmarrësit kthimin e vlerës së këstit të paguar prej tyre në shumën 13,500 USD. Sipas kërkesës së tyre gjatë komunikimeve telefonike me sipërmarrësin kjo shumë u tërhoq prej tij nga shoqëria. Kthimi i kësaj shume u krye prej sipërmarrësit në shkurt të vitit 2008. Për shkak të punësimit të bashkëshortes së tij pranë një banke të nivelit të dytë, si dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme, kjo shumë u transferua nga llogaria e bashkëshortes së tij në llogarinë e kumatit të ndjerë në SHBA, sipas kërkesës së tyre.

<sup>101</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019, dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019.

<sup>102</sup> Kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.6.2016.

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentet: (i) kontratë paraprake për shitje pasurie të paluajtshme (shkresë e thjeshtë), të mbajtur në datën 22.7.2006, midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe shtetases L. G. (e motra e subjektit), për prenotimin e pasurisë apartament, me sip. 109 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Ujin e Ftohtë, Vlorë, kundrejt çmimit 47,500 USD; (ii) mandatarkëtim nr. 167, datë 22.7.2006, në referim të të cilit është paguar kësti për prenotim apartamenti në shumën 13,500 USD; si dhe (iii) mandatpagese nr. 349, datë 13.2.2008, i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me të cilin i është paguar shtetases L. G. shuma prej 13,500 USD, për zgjidhje kontrate prenotimi, datë 22.7.2006.

Në referim të kontratës së paraqitur (të sipërcituar), shuma prej 47,500 USD do të likuidohej brenda vitit 2007, sipas kësteve: (i) kësti i parë në shumën 13,500 USD, në momentin e prenotimit në datën 22.7.2006; (ii) kësti i dytë në shumën 10,000 USD do të paguhej në datën 12.12.2006; (iii) kësti i tretë në shumën 10,000 USD do të paguhej në datën 12.6.2007; dhe (iv) kësti i katërt në shumën 14,000 USD do të paguhej në datën 12.12.2007. Në pikën 9/4 të kontratës përcaktohet se në rast se blerësi nuk respekton afatet e pagimit të kësteve, në datën e caktuar me shumën përkatëse, ose ndërron mendje për blerjen e apartamentit, sipërmarrësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë në mënyrë të njëanshme këtë kontratë dhe brenda 120 ditëve nga momenti i paraqitjes duhet t’i kthejë blerësit, të dërguarit ose përfaqësuesit të tij, shumën e arkëtuar.

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme duket se transfertat e kryer në datën 27.2.2008 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit përfaqëson pagesë për likuidimin e çmimit të blerjes së autoveturës, në konsideratë të faktit se në datën 17.3.2008 është bërë transferimi/shitja e kësaj pasurie te subjekti i rivlerësimit nga shtetasi L. H. (i cili ka qenë përfituesi i transfertës së sipërcituar).

Pasi subjekti të rivlerësimit iu kalua barra e provës në lidhje me dyshimin e ngritur nga Komisioni për këtë pasuri, subjekti, me prapësimet e dërguara dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore publike, ka parashtruar duke pretenduar se automjeti i markës “Toyota Rav 4” ka qenë pronë e kunatit të tij të ndjerë, z. L. H., e blerë prej tij në SHBA dhe e dërguar në Shqipëri për ta përdorur gjatë vizitave, si dhe për faktin se planifikonin kthimin për të jetuar përfundimisht në Shqipëri, siç edhe ka ndodhur, fakt që mund të vërtetohet lehtësisht nga të dhënat e sistemit *TIMS*.

Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti ka shpjeguar se çdo dokument ligjor që prej datës 29.2.2008 (data e blerjes së automjetit) dhe deri më 29.8.2014 (data e kryerjes së zhdoganimit të automjetit nga motra e tij, znj. L. G.), njeh dhe referon si pronar të këtij automjeti shtetasin L. H. Gjithashtu, ashtu sikurse ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, nëpërmjet prapësimeve të dërguara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka pretenduar se shuma e dërguar nëpërmjet transfertës bankare nga bashkëshortja e tij përfaqëson shumën e kthyer nga shoqëria ndërtuese, e paguar paraprakisht nga familja e kunatit (z. L. H.) për prenotimin e një apartamenti në Shqipëri nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re kontratën e huapërdorjes<sup>103</sup>, datë 29.12.2010, në referim të së cilës shtetasi L. H., në cilësinë e huadhënësit, deklaroi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë se automjetin e markës “Toyota”, tip “Rav 4” (deklaruar në pronësi të tij), ia le në përdorim shtetasve Artur dhe D. G.,

<sup>103</sup> Kontrata e huapërdorjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2010, redaktuar nga notere M. Ç..

të cilët kanë të drejtë ta drejtojnë atë për një periudhë kohe 1-vjeçare, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet se nga këqyrja/vëzhgimi i sistemit *TIMS*, shtetasi L. H (identifikuar me gjeneralitete në referim të kontratës së huapërdorjes) ka hyrë në territorin shqiptar në datën 20.9.2010 dhe ka dalë në datën 18.10.2010. Hyrja tjetër e këtij shtetasi në Shqipëri dokumentohet në datën 7.7.2011. Pra, rezulton se ky shtetas nuk ka qenë në territorin shqiptar në datën e pretenduar të lëshimit të kësaj deklaratë.

▼ **Për sa më sipër, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme lidhur me ekzistencën e kësaj kontrate huapërdorjeje. Duket se kemi të bëjmë me një kontratë fiktive huapërdorjeje, qëllimi i së cilës është mbështetja e deklarimeve të subjektit lidhur me këtë automjet.**

Në vijim, nëpërmjet prapësimeve të dërguara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka parashtruar se vetë fakti se procedura e zhdoganimit të automjetit është kryer në emër të së motrës, znj. L. G., tregon se kjo është pasuri e saj/bashkëshortit të saj (të ndjerit L. H.). Por, në kushtet kur motra e subjektit nuk ka pasur dokumente shqiptare, ky automjet është regjistruar në emrin e tij.

Në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe provave mbështetëse të depozituara prej tij, Komisioni vlerëson se në kushtet kur ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar që në vitin 2008 – procedura e zhdoganimit të tij është bërë mbi bazën e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti apo familjarët e tij.

Me rëndësi paraqitet momenti i regjistrimit të automjetit në DRSHTRR-në Tiranë. Krahas dokumentit të zhdoganimit dhe dokumenteve të tjera shoqëruese (certifikatë e kontrollit fizik, dokument identifikimi etj.) për regjistrimin e automjeteve është i nevojshëm/detyrueshëm dorëzimi i dokumentit të vlefshëm për fitimin e pronësisë.

Rezulton se ky automjet është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentin certifikatë titulli automjeti, lëshuar në datën 17.3.2008 në SHBA, sipas të cilit është blerë në SHBA nga shtetasi L. H. në datën 29.2.2008 dhe në datën 17.3.2008 është bërë transferimi/shitja nga shtetasi L. H. te subjekti i rivlerësimit. Duhet vënë në dukje se në përkthimin e këtij dokumenti – të depozituar në DRSHTRR për regjistrimin e tij, duket se ka një “gabim material”, nga ku në vend që të përkthehej: *Nënshkrimi i blerësit/blerësve Artur Gaxha (nënshkrim), emri i printuar ARTUR GAXHA*, është përkthyer: *Nënshkrimi i shitësit/shitësve Artur Gaxha (nënshkrim), emri i printuar ARTUR GAXHA*.

Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokumentacion për të provuar faktin se shtetasi L. H. ka qenë bashkëshorti i motrës, znj. L.G. Në këtë këndvështrim nuk mund të merren në konsideratë pretendimet e subjektit se shuma e transferuar në favor të shtetasit L. H. ka të bëjë me “kthim shume” për pasuri të prenotuar në Shqipëri, pasi në referim të kontratës së sipërmarrjes kjo pasuri ishte prenotuar nga znj. L. G., e motra e subjektit.

Komisioni kreu kërkime në faqen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare<sup>104</sup>, me qëllim verifikimin në bazën elektronike të të dhënave të këtij autoriteti – të përfituara nga shoqëritë e sigurimit që lidhen me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit (policat e sigurimit), ku përfshihen MPTL e brendshme, Kartoni Jeshil dhe Sigurimi Kufitar. Nga verifikimi i të dhënave

<sup>104</sup> Duke u loguar në këtë sistem me *username* dhe *pasëordin* përkatës të vendosur në dispozicion nga AMF.

të pasqyruara në këtë sistem, rezultoi se referuar policës së sigurimit Karton Jeshil, të shitur në datën 21.8.2008 (data e fillimit 21.8.2008 – data e mbarimit 4.9.2008) për automjetin e tip “Toyota”, me targa \*\*\* (targë e cila i përkiste automjetit, objekt hetimi para regjistrimit në Shqipëri) është shënuar si pronar z. Artur Gaxha.

Gjithashtu, në prapësimet e tij subjekti ka kundërshtuar lidhjen e bërë nga Komisioni mes transfertës së bërë nga bashkëshortja dhe blerjes së automjetit tip “Toyota”, pasi sipas tij, në kushtet kur referuar dokumentacionit të depozituar<sup>105</sup>, ky automjet është blerë nga kunati i tij në shumën 31,650 USD, ndërkohë që transferata e bërë nga bashkëshortja është në vlerën 13,500 USD.

Në vlerësimin tërësor dhe në harmoni i provave të administruara, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë këtij procesi, trupi gjykues krijoi bindjen se transferata e kryer nga bashkëshortja e në favor të shtetasit L. H. është bërë me qëllim likuidimin e çmimit të blerjes së automjetit të markës “Toyota”, tip “Rav” 4.

↓ **Për sa më sipër, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se kjo pasuri është porositur, blerë dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri/të drejtat reale që zotëronte mbi të dhe duket se nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tij është munduar të fshehtë ekzistencën e këtij automjeti dhe zotërimin e tij.**

Në dritën e të dhënave të reja të paraqitura nga subjekti lidhur me vlerën e blerjes së këtij automjeti nga shtetasi L. H. (i cili duket se është blerë nga kompania “Toyota” në SHBA, me zero kilometra), duket se vlera fillestare e paguar për blerjen e tij është më e lartë nga ajo çka është paraqitur në analizën financiare si e paguar nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur. Gjithsesi, në mungesë të provave bindëse, trupi gjykues përfundimisht vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën prej 13,500 USD për blerjen e automjetit (dokumentuar si shumë e transferuar nëpërmjet bankës në favor të blerësit fillestar, z. L. H.).

❖ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimit të prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe verifikimin e kryer për burimet financiare të deklaruara për blerjen e pasurive, shtesat në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera – Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008, të pasqyruar në tabelën si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat nga pagat, subjekti i rivlerësimit	872,875
Të ardhura nga pagat, bashkëshortja e subjektit	1,555,186
Të ardhura nga interesat bankare	183,671
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>2.611.732</b>

<sup>105</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – i cili nuk është në formën e kërkuar nga ligji, madje as i përkthyer.

Shpenzime për telefoni celulare, pagesa të evidentuara nga “Raiffeisen Bank”	188,200
Shpenzime për kredi	347,990
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi) <sup>106</sup>	101,207
Transfertë/pagesë nga llogarie e bashkëshortes, shuma 13,489 USD	1,185,819
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	546,480
<b>Total shpenzime/ të dala financiare</b>	<b>2,369,696</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	-523,648
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-281,612</b>

↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2008.

#### 47.2 Apartamenti i prenotuar në vitin 2006, në Golem, Durrës

Siç është evidentuar më sipër, konstatohet se, referuar kontratës së datës 27.6.2006, subjekti i rivlerësimit ka porositur te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., apartament banimi me vlerë 41,000 euro, me plan pagesash, si vijon: (i) me nënshkrimin e kontratës u pagua shuma 25,000 euro; (ii) shuma prej 10,000 euro do të jepet deri në datën 25.9.2006; dhe (iii) shuma prej 6,000 euro do të shlyhet me dorëzimin e apartamentit. Në referim të nenit 5 të kësaj kontrate, dorëzimi i apartamentit do të bëhet jo më vonë se dhjetori i vitit 2006.

Kjo pasuri është deklaruar në DPV-në e vitit 2007, në të cilën deklarohet vlera prej 41,000 euro, vlera e paguar prej 25,000 euro dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese në vlerën prej 16,000 euro. Referuar DPV-së së vitit 2008, subjekti ka deklaruar pagesën e kryer në shumën prej 11,000 euro dhe detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë në shumën prej 5,000 euro. Ky detyrim pasqyrohet të ketë mbetur edhe gjatë vitit 2009, bazuar në deklarinimin e bërë nga subjekti për këtë periudhë në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” në DPV-në e vitit 2009.

**Rezulton se në DPV-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar porositjen e kësaj pasurie dhe pagesat e kryera për të.**

Gjithashtu, konstatohet se në DPV-në e vitit 2006, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar kredi 5-vjeçare në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes, e marrë në shkurt të vitit 2006, me vlerë 1,500,000 lekë.

Referuar të dhënave të dërguara nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 24.1.2006 bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë kredie (personale, mobilim etj.) me kredidhënës “Raiffeisen Bank” dhe bashkëkredimarrës Artur Gaxha, në referim të së cilës banka është dakord t’i japë kredimarrësit një kredi deri në shumën 1,500,000 lekë dhe se qëllimi i dhënies së kredisë është *përdorim për mobilim shtëpie*. Konstatohet se, referuar nenit 8 të kësaj kontratë kredie, si

<sup>106</sup> Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit janë reduktuar shpenzimet e udhëtimit të dokumentuara si të kryera për shkak të detyrës dhe shpenzimet e qëndrimit, për udhëtimin për të cilin është deklaruar qëndrimi tek vëllai i bashkëshortes në Greqi.

barrë siguroese janë vendosur mallrat e arredimit, mobiliet dhe aksesorët me vlerë 1,500,000 lekë (bashkëlidhur oferta nga mobilieri \*\*\*, datë 19.1.2006).

**Për sa më sipër, konstatohet se shuma e marrë nga kjo kredi ka shërbyer për mobilim dhe nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për prenotimin e apartamentit në Golem, Durrës.**

Në referim të kontratës së sipërmarrjes datë 27.6.2006, të nënshkruar me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për prenotimin e apartamentit në Golem me sip. 72 m<sup>2</sup>, Komisioni vlerësoi se gjatë vitit 2006 është paguar nga subjekti shuma prej 35,000 euro (shuma 25,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës + shuma 10,000 euro deri në datën 25.9.2006). Si rrjedhim, shuma prej 35,000 euro është përfshirë në analizën financiare të vitit 2006 si shumë e paguar për porositjen e kësaj pasurie.

- Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se:
- së pari, duke qenë se bëhet fjalë për deklaratimet e vitit 2006, nuk ka pasur asnjë qëllim për fshehjen e kësaj pasurie – ky qëndrim përforcohet nga fakti se e ka deklaruar në deklaratën e vitit pasardhës, DPV-në e vitit 2007;
  - së dyti, pretendon se gjatë vitit 2006 ka kryer vetëm pagesën e këstit të parë, në shumën prej 25,000 euro.

Në vlerësimin e kësaj pasurie, Komisioni u fokusua në verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive.

Në këtë kuptim, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për vitin 2006, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për kryerjen e pagesave për prenotimin/blerjen e apartamentit në Golem, Durrës.

- Duke pasqyruar në mënyrë të përmbledhur prapësimet e subjektit të rivlerësimit për analizën financiare të vitit 2006, konstatohet se ai pretendon reflektimin në këtë analizë të ndryshimeve sipas kërkesave, për sa vijon:

i) shuma totale e paguar gjatë vitit 2006 për blerjen e kësaj pasurie është në vlerën 25,000 euro;

ii) të ardhurat nga kredia kanë shërbyer si burim për pagesat e kryera për prenotimin/blerjen e apartamentit në Golem në vitin 2006;

iii) reduktimin e shpenzimeve telefonike; dhe

iv) heqjen nga tabela e analizës financiare, në zërin shpenzime “humbjet nga kursi i këmbimit”, duke pretenduar se nuk ka asnjë veprim këmbimi prej tij që shkakton një humbje të tillë, pasi kësti prej 25,000 euro është përballuar nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 28.4.2005, shumë e cila, siç vërtetohet nga deklaratat noteriale e shtetasit V. Y.<sup>107</sup>, është likuiduar përpara datës së revokimit të kontratës, në të njëjtën monedhë.

Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit janë kryesisht të karakterit deklarativ, pasi provat

---

<sup>107</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.6.2020 – depozituar si provë e re me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit.



e depozituara nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të bëra dhe të pasqyruara/reflektuara në analizën financiare të vitit 2006.

- ❖ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2006, të pasqyruar në tabelën, si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2006</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat e subjekti të rivlerësimit	783,969
Të ardhurat e bashkëshortes	<b>970,712</b>
Kredi nga “Raiffeisen Bank” për mobilim	1,500,000
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>3,254,681</b>
Shpenzime për telefoni celulare “Raiffeisen Bank”	306,456
Shpenzime për kredi	318,992
Shpenzime mobilimi ***	1,500,000
Humbje nga kurset e këmbimit	172,214
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi)	167,198
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	438,228
<b>Total shpenzime</b>	<b>2,903,088</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	-600,000
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	227,323
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-21,084</b>
Blerje apartamenti, Golem, në shumën 41,000 euro, referuar kontratës së sipërmarrjes	5,077,850
<b>Total pasuri</b>	<b>5,077,850</b>
Detyrime ndaj shoqërisë së ndërtimit 6,000 euro	743,100
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>4,334,750</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>- 4,355,834</b>

- ↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme (shtesën e likuiditeteve *cash*) dhe të paluajtshme (pagesën e kryer për prenotim apartamenti), si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2006.

**47.3 UK Kavajë<sup>108</sup>** informon se, bazuar në të dhënat e sistemit të faturim-arkëtimit subjekti i rivlerësimit ka kontratën me nr. 26371, me debi në shumën 41,112 lekë dhe se nuk ka kryer asnjë pagesë për këtë kontratë.

<sup>108</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020.

Në referim të këtij informacioni të dërguar nga UK Kavajë duket se subjekti i rivlerësimit ka marrëdhënie kontraktuale me këtë shoqëri, ndërkohë që nuk ka deklaruar pasuri në pronësi/përdorim në territorin që mbulon me shërbim kjo shoqëri aksionere.

Pas kalimit të barrës së provës lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk është kryer asnjëherë prej tij aplikimi për të lidhur kontratën e furnizimit me ujë dhe nuk ka pasur asnjë dijeni për ekzistencën e kësaj kontrate në emrin e tij. Nuk ka asnjë pronë në territorin që mbulohet nga UK Kavajë dhe askund tjetër, përveç sa ka deklaruar në DPV-të përkatëse. Pas verifikimeve të kryera prej tij rezulton se kjo kontratë lidhet me apartamentin me sip. 72 m<sup>2</sup>, të porositur prej tij në vitin 2006 dhe të revokuar në vitin 2010 – apartament për të cilin, siç ka deklaruar, nuk është marrë në asnjë moment në dorëzim. Vlerëson se, referuar praktikës së ndeshur shpesh nga shoqëritë sipërmarrëse, aplikimi për lidhjen e kontratës për furnizimin me ujë është kryer prej shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në funksion të kontratës së sipërmarrjes së nënshkruar dhe se është neglizhuar prej kësaj shoqërie dhe porositësit të ri kryerja e ndryshimeve përkatëse në funksion të revokimit të kontratës së sipërmarrjes. Ndërkohë që, sipas verifikimeve kjo procedurë duket të jetë kryer në kohë për kontratën e furnizimit me energji elektrike.

Për të mbështetur deklaratimet e tij subjekti ka depozituar dokumentacionin provues, si vijon: (i) dy shkresa<sup>109</sup> nga UK Kavajë të datës 6.5.2020; (ii) dy shkresa<sup>110</sup> nga OSHEE – Furnizuesi i Shërbimit Universal, të datës 14.5.2020; (iii) kontratë<sup>111</sup> sipërmarrjeje datë 4.11.2010; (iv) shkresë tjetër<sup>112</sup> e UK Kavajë, datë 6.5.2020; dhe (v) librezë uji për kontratën nr. \*\*\* dhe faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 2.6.2020.

Referuar shkresës datë 6.5.2020, të UK Kavajë, në bazë të verifikimeve të kryera në sistemin e faturim-arkëtim të UKKA për periudhën 2008 – 2020 në Degën e Shitjes, z. Artur Gaxha ka një kontratë me nr. \*\*\*, të hapur në vitin 2008 sipas listës së emrave që vinte në dispozicion administratori i ndërtesës dhe nuk disponohet asnjë dokument tjetër për hapjen e kësaj kontrate pranë Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a.

Pas kërkesës së bërë nga subjekti, Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE Group) ka konfirmuar se referuar sistemit të tyre të faturimit – me gjeneralitet Artur S. Gaxha dhe D. H. G., nuk rezulton të ketë abonent dhe kontratë të furnizimit me energji elektrike me OSHEE sh.a., në instancën e Kavajës.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga subjekti, duket se në pas revokimit të bërë prej tij dhe shoqërisë të apartamentit në Golem, kjo pasuri nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes datë 4.11.2010, është porositur nga shtetasi A. C. Referuar të dhënave të OSHEE-së me gjeneralitetet e këtij shtetasi identifikohet një abonent në instancën e Kavajës, me datë hapje 8.7.2014, ndërsa sipas të dhënave të dërguara nga UK Kavajë ky shtetas nuk ka/nuk ka pasur kontratë të lidhur me këtë shoqëri. Në vijim, duket se shtetasi A. C., ka aplikuar për ndryshimin e emrit në kontratën me nr. \*\*\* – duke paguar detyrimet përkatëse sipas faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 2.6.2020, e cila ka përshkrimin “kn \*\*\* Artur Gaxha do kthehet në emrin

<sup>109</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020.

<sup>110</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020, dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020.

<sup>111</sup> Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.11.2010.

<sup>112</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020.

e H. C.”. Bazuar në aplikimin e bërë duket se nga UK Kavajë është nxjerrë librezja e ujit në emër të shtetasit H. C., e cila referon kontratën nr. \*\*\*.

↓ Për sa më sipër, nga analizimi me objektivitet dhe paanësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në harmoni me të gjithë provat të administruara në dosje, Komisioni krijoi bindjen se kjo kontratë ka qenë e lidhur me pasurinë e porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 – për të cilën subjekti ka hequr dorë nga të drejtat që zotëronte mbi të me kontratën e revokimit të vitit 2010. Pra, si konkluzion, nuk provohet dijenia e subjektit për ekzistencën e kësaj kontrate dhe nuk ka dyshime për pasuri të fshehur të lidhur me të.

#### 47.4 Analiza financiare, vitet të cilat kanë rezultuar me balanca negative të fondeve

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për periudhën 2003 – 2016, nga ku veç periudhave të evidentuara më sipër në trajtimin e pasurive të krijuara nga subjekti, evidentohen se edhe vitet 2012 dhe 2013 paraqiten me balancë negative të fondeve.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Në analizë të shpjegimeve dhe të provave të reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pasi Komisioni i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, reflektoi ndryshimet në analizën financiare, duke pasqyruar të plota të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitin 2013, në referim të analizës së kryer më sipër. Pretendimet e tjera të subjektit për analizën financiare janë të karakterit deklarativ, të pabazuara në dokumentacionin justifikues ligjor dhe, si të tilla, nuk u morën në konsideratë nga Komisioni.

Si përfundim, analiza e treguesve financiarë për vitet 2012 dhe 2013 paraqitet e pasqyruar në tabelën, si vijon:

<b>Analiza financiare</b>		
<b>Viti</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga paga, për periudhën	1,023,294	1,051,336
Të ardhura nga shpërblimet, FSHF	0	45,000
Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, për periudhën	2,351,781	2,428,507
Të ardhura nga qiraja	0	253,679
Të ardhura nga shitja e ap. në Rr. “***”, viti 2013 ( vlerësuar në rezervë) <sup>113</sup>	0	43,775,245
Të ardhura nga interesa/sistemim kurset e këmbimit	692,793	630,307
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>4067,868</b>	<b>48,184,074</b>
Shpenzime për telefoni celulare “Credins Bank”	112,744	0
Shpenzime për kredi “Raiffeisen “Bank”	1,085,631	1,000,125
Shpenzime për shkollim, studim dhe eksp. profesionale	673,522	1,513,511
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (transporti dhe qëndrimi)	1,025,872	874,125

<sup>113</sup> Në referim të analizës së kryer nuk është përfshirë shuma prej 137,788 euro si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit/apartamenteve në Rr. “\*\*\*” – vlerësuar nga trupi gjykues si fitim kapital i personit të lidhur, për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore. Në këtë kuptim, meqenëse shitblerja e apartamentit/apartamenteve është kryer brenda vitit 2013 – në analizën e financiare kjo shumë është reduktuar në të ardhurat e përfituara nga shitja.

Shpenzime për sigurime	108,880	227,140
Shpenzime tatime dhe taksa dhe rivlerësim/hipotekim pasurish të paluajtshme	0	206,300
Shpenzime mobilimi/arredimi/rivlerësimi, etj.	977,130	456,054
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	558,192	564,096
<b>Total shpenzime/ të dala financiare</b>	<b>4,541,971</b>	<b>4,841,351</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. Fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	0	0
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	-1,429,234	-63,514,782
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-1,903,337</b>	<b>-20,172,059</b>
<b>Total pasuri</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Detyrime	0	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-1,903,337</b>	<b>-20,172,059</b>

↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2012 dhe 2013.

#### 48. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se, **subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve ndër vite.**

Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit **ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë**, parashikuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe se vendimarrja për këtë subjekt të mund bazohet vetëm në kriterin e pasurisë sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit 84/2016.

## B. KONTROLI I FIGURËS

**49.** Drejtorja e Sigurimit së Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>114</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me

<sup>114</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017.

përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale, apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha<sup>115</sup>.

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **50. Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gurmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **❖ Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>116</sup>**

**51.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar një raport për analizën e aftësive profesionale, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të cilat janë paraqitur prej tij; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Artur Gaxha janë paraqitur gjithsej 15 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së. 8 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, 4 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 3 si ankesa të përsëritura më parë dhe një me arsyetimin se është tej afatit 5-vjeçar.

7 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon:

- 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar bazuar mbi informacionin periodik ardhur nga kryetari i gjykatës lidhur me vendimet e cenuara, i është regjistruar gjyqtarit për efekt të vlerësimit profesional dhe etik;
- 4 ankesa të vitit 2016, verifikuar për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

<sup>115</sup> Raporti për kontrollin e figurës është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2020, të KDZH-së.

<sup>116</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 19.04.2019.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Artur Gaxha, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Në raportin e vlerësimit profesional janë listuar disa problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për aspekte të veçanta të gjykimit për dosje të ndryshme të vëzhguara.

Por, referuar raportit konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, në përgjithësi identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor.

Për gjyqtarin Artur Gaxha konstatohet se ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe bën përpjekje për përfundimin në kohë të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësinë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore tepër e lartë.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

## **52. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 23 denoncime të depozituara nga publiku në Komision, të cilat në shumicën prej tyre janë adresuar edhe ndaj subjekteve të tjera të rivlerësimit, si dhe disa i përkasin çështjeve gjyqësore të cilat janë gjykuar përpara vitit 2006, përcaktuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 si periudha prej nga mund të nisë, e në vijim të shtrihet vlerësimi i aftësive profesionale.

Subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara nga raporti i KGJ-së dhe nga verifikimi i denoncimeve të depozituara në Komision. Subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar problematikën mbi këto gjetje, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional.

### **53. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, si dhe pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Gaxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 10.09.2020

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Pamela QIRKO**  
**Relatore**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*